



REPUBLIKA E KOSOVËS
Komuna e Drenasit
Kuvendi i Komunës



Nr. 02-060101-42377 dt. 24/08/ 2023

Në bazë të nenit 43 të Ligjit nr. 03/L-40 për vetëqeverisje Lokale, neni 36,41 dhe 42 pika 42.2 të Statutit të Komunës së Drenasit (Glllogocit), neni 3 pika 3.7 si dhe neni 12 pika 12.2 të Rregullores së punës të Kuvendit, Kryesuesi i Kuvendit të Komunës z. Milaim Hajdari, më datë: **31.08.2023** (e enjte) duke filluar në ora 10:00 në sallën e Kuvendit të Komunës.

THËRRET
MBLEDHJEN E RREGULLT TË KUVENDIT TË KOMUNËS

Mbledhja do të ketë këtë:

Rend dite:

1. Procesverbali i mbledhjes së rregullt të Kuvendit Komunal i dt.27.07.2023.
2. Propozim Vendim për faljen e tatimit në pronë për vitin tatimor 2023.
3. Propozim Vendim për caktimin e normave tatimore për Tatimin në Pronën e Paluajtshme për vitin 2024.
4. Raporti i punës Janar-Qershor 2023, i Kryetarit dhe Qeverisjes Lokale.
5. Propozim Vendim për financimin e Projektit të OJQ-ve nga Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, "Klubi i Hendbollit Drenica"
6. Propozim Vendim për financimin e Projektit të OJQ-ve nga Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, "FC Liqeni"
7. Propozim Vendim për financimin e Projektit të OJQ-ve nga Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit "Klubi i Boksit Drenasi"
8. Propozim Vendim për financimin e Projektit të OJQ-ve nga Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, "Klubi i Futbollit" Feronikeli " Femra.
9. Propozim Vendim për financimin e Projektit të OJQ-ve nga Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, KV "Feronikeli" Meshkuj.
10. Propozim Vendim për financimin e Projektit të OJQ-ve nga Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, SIIKA "Shotë Galica"
11. Propozim Vendim për financimin e Projektit të OJQ-ve nga Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, KV "Feronikeli Femrat"
12. Propozim Vendim për financimin e Projektit të OJQ-ve nga Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, "SHKA SHQIPET E DRENICES"

13. Propozim Vendim për financimin e Projektit nga Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, për projektin e Lulzim Nika, për projektin Botimi i Librit “Kosova në dokumentet e qeverisë Amerikane 1945-99” gjatë vitit 2023.
14. Propozim Vendim për financimin e Projektit të OJQ-ve nga Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, ” Fc Feronikeli 74”.
15. Propozim Vendim për financimin e Projektit OJQ-ve nga Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, ”KV Gryka”.
16. Raport i takimit të komisionit i cili do të ndihmojë dhe rekomandojë Kryetarit të Komunës në lidhje vlerësimin e kërkesave të pranuar për dhënie të pronave me negociim .
17. Propozim vendim për miratimin e Kërkesës, nr 06-070/01-39017, dt 09.08.2023, për ndihmë financiare për mjekim urgjent të sëmundjes kancer, Adenocarcinoma ductalis pancreatis, në shumën totale prej 1,600.00 euro.
18. Propozim vendim për miratimin e Kërkesës, nr 06-070/01-41320, dt 21.08.2023, për ndihmë financiare për mjekim urgjent të sëmundjes kancer, Adem. Carcinom, dhe sëmundjes Arrest Kardio respirator, në shumën totale prej 1,600.00 euro.
19. Propozim vendim për miratimin e Kërkesës, nr 01-070/01-0041969/23, dt 23.8.2023, për ndihmë financiare për mjekim urgjent të sëmundjes kancer ovarian në shumën totale prej 1,600.00 euro.
20. Të ndryshme.

Drenas, 24.08.2023



Kryesuesi i Kuvendit të Komunës

Milaim Hajdari

REPUBLIKA E KOSOVËS KOMUNA GLLOGOC GLLOGOC MUNICIPALITY			
PRANUAR		24 08 2023	
Nj. Org.	Numër	Shtojca	Vlera
02-	060101	42377	



REPUBLIKA E KOSOVËS
Komuna e Drenasit
Zyra e Kuvendit



**Rekomandimet e dhëna nga Komiteti për Politikë dhe Financa në mbledhjen
e rregullt të mbajtur me datë 24.08.2023, si vijon:**

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Milaim Hajdari- pasi përshëndeti të pranishmit, deklaroi të hapura punimet e mbledhjes të Komitetit për Politikë dhe Financa, ku prezantoi rendin e ditës, theksoi se kemi edhe një pikë shtesë për rend ditë: Propozim vendim për miratimin e Kërkeses, nr 01-070/01-0041969/23, dt 23.8.2023, për ndihmë financiare për mjekim urgjent të sëmundjes kancer ovarian në shumën totale prej 1,600.00 euro.

Meqë nuk pati diskutime vërejtje apo sugjerime kryesuesi hodhi në votim rendin e ditës, prezent gjatë votimit ishin 6 anëtar dhe votuan me: 05 vota “Për”, 1 kundër, abstenim nuk pati, u miratua rendi i ditës.

1. Procesverbali i mbledhjes së rregullt të Kuvendit Komunal i dt.27.07.2023.

Meqë nuk pati diskutime vërejtje apo sugjerime kryesuesi hodhi në votim rendin e ditës, prezent gjatë votimit ishin 6 anëtar dhe votuan me: 06 vota “Për”, kundër nuk pati, abstenim nuk pati, u miratua procesverbali i KPF-së

2. Propozim Vendim për faljen e tatimit në pronë për vitin tatimor 2023.

Meqë nuk pati diskutime vërejtje apo sugjerime kryesuesi hodhi në votim rendin e ditës, prezent gjatë votimit ishin 6 anëtar dhe votuan me: 06 vota “Për”, kundër nuk pati, abstenim nuk pati, u rekomandua për kuvend kjo pikë e rendit të ditës.

3. Propozim Vendim për caktimin e normave tatimore për Tatimin në Pronën e paluajtshme për vitin 2024.

Meqë nuk pati diskutime vërejtje apo sugjerime kryesuesi hodhi në votim këtë pikë të rendit të ditës prezent gjatë votimit ishin 6 anëtar dhe votuan me: 06 vota “Për”, kundër nuk pati, abstenim nuk pati, u rekomandua për kuvend kjo pikë e rendit të ditës.

4. Raporti i punës janar-qershor 2023 i kryetari të komunës së Drenasit.
U rekomandua për kuvend kjo pikë e rendit të ditës.

5. Propozim Vendim për financimin e Projektit të OJQ-ve nga Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, “Klubi i Hendbollit Drenica”
6. Propozim Vendim për financimin e Projektit të OJQ-ve nga Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, “FC Liqeni”
7. Propozim Vendim për financimin e Projektit të OJQ-ve nga Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit “Klubi i Boksit Drenasi”
8. Propozim Vendim për financimin e Projektit të OJQ-ve nga Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, “Klubi i Futbollit Feronikeli –Femra”
9. Propozim Vendim për financimin e Projektit të OJQ-ve nga Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit,”Kv Feronikeli Meshkuj”
10. Propozim Vendim për financimin e Projektit të OJQ-ve nga Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit,” SHKA Shotë Galica”

11. Propozim Vendim për financimin e Projektit të OJQ-ve nga Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit,” Kv Feronikeli Femrat”
12. Propozim Vendim për financimin e Projektit të OJQ-ve nga Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit,” SHKA SHQIPET E DRENICES”
13. Propozim Vendim për financimin e Projektit të OJQ-ve nga Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit,” për projektin e Lulzim Nika, për projektin Botimi i Librit “Kosova në dokumentet e qeverise Amerikane 1945-99 gjatë vitit 2023.
14. Propozim Vendim për financimin e Projektit të OJQ-ve nga Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit,” Fc Feronikeli 74”.
15. Propozim Vendim për financimin e Projektit OJQ-ve nga Drejtoria e Kulturës,Rinisë dhe Sportit,”KV Gryka”.

Meqë nuk pati diskutime vërejtje apo sugjerime kryesuesi hodhi nëvotim prej pikës 5 deri tek pika 14, prezent gjatë votimit ishin 6 anëtar dhe votuan me: 5 vota “Për”, kundër nuk pati, 1 abstenim.

16. Raport i takimit të komisionit i cili do të ndihmojë dhe rekomandojë Kryetarit të Komunës në lidhje vlerësimin e kërkesave të pranuar për dhënie të pronave me negociim .

Meqë nuk pati diskutime vërejtje apo sugjerime kryesuesi hodhi në votim prezent gjatë votimit ishin 6 anëtar dhe votuan me: 6 vota “Për”, kundër nuk pati, abstenim nuk pati.

17. Propozim vendim për miratimin e Kërkeses, nr 06-070/01-39017, dt 09.08.2023, për ndihme financiare për mjekim urgjent të sëmundjes kancer, Adenocarcinoma ductalis pancreatis, në shumën totale prej 1,600.00 euro.

Meqë nuk pati diskutime vërejtje apo sugjerime kryesuesi hodhi në votim prezent gjatë votimit ishin 6 anëtar dhe votuan me: 6 vota “Për”, kundër nuk pati, abstenim nuk pati.

18. Propozim vendim për miratimin e Kërkeses, nr 06-070/01-41320, dt 21.08.2023, për ndihme financiare për mjekim urgjent të sëmundjes kancer, Adem. Carcinom, dhe sëmundjes Arrest Kardio respirator, në shumën totale prej 1,600.00 euro.

Meqë nuk pati diskutime vërejtje apo sugjerime kryesuesi hodhi në votim prezent gjatë votimit ishin 6 anëtar dhe votuan me: 6 vota “Për”, kundër nuk pati, abstenim nuk pati.

19. Propozim vendim për miratimin e Kërkeses, nr 01-070/01-0041969/23, dt 23.8.2023, për ndihmë financiare për mjekim urgjent të sëmundjes kancer ovarian në shumën totale prej 1,600.00 euro.

Meqë nuk pati diskutime vërejtje apo sugjerime kryesuesi hodhi në votim prezent gjatë votimit ishin 6 anëtar dhe votuan me: 6 vota “Për”, kundër nuk pati, abstenim nuk pati.

20. Të ndryshme.

Pati diskutime në interes të përgjithshëm të asamblesë komunale.

Drenas, 24.08.2023



Kryesuesi i Kuvendit të Komunës

Milaim Hajdari



Republika e Kosovës

Komuna e Drenasit

Kuvendi i Komunës



Nr. 060/01-42378 dt. 24/08/2023

PROCESVERBALI

Të mbledhjes së rregullt të Kuvendit Komunal të Drenasit të Mbajtur më datë: **27.07.2023**
e cila filloi në orën 10:00.

Mbledhjen e kryesoi kryesuesi i Kuvendit Komunal-Milaim Hajdari

Kryesuesi deklaroi të hapura punimet e mbledhjes së rregullt të Kuvendit Komunal, ku të pranishëm ishin 30 anëtarë: Labinot Halilaj (PDK), Bekim Lestrani (PDK), Arigon Sinani (PDK), Zeqir Hasi (PDK), Laurita Muhadri Bujupi (PDK), Hamit Kastrati (PDK), Blerina Gashi (PDK), Gani Krasniqi (PDK), Fatmir Baliu (PDK), Qendrim Mulaj (PDK), Malsore Cakiqi (PDK), Blerina Gashi (PDK), Albulena Saliuku (PDK), Valentina Leku (PDK), Manushaqe Mulaku (PDK), Mirlinda Dvorani (PDK) Sali Dvorani (DD), Mergim Pirraku (DD), Mehedin Salihu (DD), Hamit Haxhiu (DD), Jahir Hajdari (DD), Azemine Bujupi-Gjoka (DD), Marigona Bazaj (DD), Florentina Elezi-Veliu (VV), Filloreta Bujupi (VV), Drin Halilaj (VV), Egzona Terrdevci (VV), Muhamet Kurtaj (VV), Arbër Halilaj (GREEN), Beqir Kiqina (AAK), Egzon Qorri (LDK). Sali Dvorani (DD). **Mungoi Azemine Gjoka.**

Rend dite:

1. Procesverbali i mbledhjes së rregullt të Kuvendit Komunal i dt.29.06.2023.
2. Informim i Kuvendit Komunal për aktivitetet e Këshillit Komunal Për Siguri në Bashkësi.
3. Propozim vendim për miratimin e Kërkesës, Nr. 06-070/01-19409,dt:25.04.2023,për ndihmë financiare për mjekim të sëmundjes me diagnozë: Aneurisma A-basilaris, SAH dhe HIC, në shumën totale prej 3,000.00 euro.
4. Propozim vendim për miratimin e kërkesës , Nr. 01-070/34686 dt. 18.07.2023 për ndihmë financiare për mjekim urgjent të sëmundjes me diagnozë Eëing Sarcoma reglumbalis, në shumën totale prej 2.790 euro .
5. Raporti i Auditimit për pasqyrat Financiare vjetore të Komunës së Gllgovcit për vitin 2022.
6. Raporti Financiar Janar-Qershor 2023.
7. Raporti i kompanisë KRM "Pastrimi"
8. Propozim vendim për ndryshim-plotësimin e rregullores për Taksa, Tarifa, Ngarkesa dhe Gjoka.
9. Propozim Vendim për financimin për projektin e OJQ "Klubi i Hendbollit Drenica"
10. Propozim Vendim për financimin për projektin e OJQ "FC Liqeni"
11. Propozim Vendim për financimin për projektin e OJQ "Klubi i Boksit Drenasi"
12. Propozim Vendim për financimin për projektin e OJQ "Klubi i Futbollit Feronikeli – Femrat"

13. Propozim Vendim për financimin për projektin e OJQ "KV Feronikeli Meshkuj"
14. Propozim Vendim për financimin për projektin e OJQ "KV Feronikeli Femrat"
15. Propozim Vendim për financimin për projektin e OJQ "SHKA Shotë Galica"
16. Propozim Vendim për financimin për projektin e OJQ, "SHKA SHQIPET E DRENICES"
17. Propozim Vendim për financim për projektin e Lulzim Nika, për projektin Botimi i Librit "Kosova në Dokumentet e Qeverisë Amerikane 1945-99" gjatë vitit 2023.
18. Propozim Vendim për financimin për projektin e OJQ "Fc Feronikeli 74".
19. Propozim Vendim për financimin për projektin e OJQ "Kv Gryka".
20. Propozim vendim për krijimin e komisionit i cili do të ndihmojë dhe rekomandojë Kryetarit të Komunës në lidhje vlerësimin e kërkesave të pranuar për dhënie të pronave me negociim.
21. Propozim vendim për rritjen dhe bartjen e të hyrave vetanake.
22. Propozim vendim për caktimin e lokacionit për realizimin e Projektit për ndërtimin e objekteve kolektive për banim social.
23. Plan i veprimit për implementimin e rekomandimeve të raportit të auditorit.
24. Të ndryshme.

Të pranishëm ishin edhe **Kryetari i Komunës, Ramiz Lladrovci, Nënkryetari i Komunës Arben Shala, Drejtor të Drejtorive komunale, zyra e informimit, Përfaqësues të kompanisë KRM "Pastrimi" qytetar.**

Mbledhja e rregullt e Kuvendit të Komunës së Drenasit u mbajt me dt. 27.07.2023, ku për diskutim ishin 24 pika për rend dite. Mbledhja është kryesuar nga kryesuesi i Kuvendit Komunal, Milaim Hajdari. Kryesuesi hapi punimet e mbledhjes së rregullt të Kuvendit Komunal ku njoftoi me rendin e ditës:

Arbër Halilaj, sa i përket rendit të ditës deshta të ndalem tek pika e 18. Propozim Vendim për financimin për projektin e OJQ "Fc Feronikeli 74" klubit të futbollit nga Drenasi që këtë vit garon në super lig, kërkoj që këtë pikë ta shtym për një seancë të radhës meqë ka shumë pa qartësi të krijuara në këtë klub dhe nuk duam të bijm në lajthitje si asamble dhe të votojmë për këtë pikë tani. Pyetja ime direkte është se asambleja të njoftohet se a e një FIFA dhe UEFA në kuadër të se cilës vepron FFK Klubi i ri "Feronikeli 74" të cilën ne po diskutojmë ta subvencionojmë. Këtij klubi me sa di ju patën blloku dhe transferet për shkak të problemeve financiare dhe kontratat me lojtarët prandaj financimi nuk është urgjent dhe nuk kemi pse të votojmë diçka që na vë në pozitë që të bëjmë ndonjë shkelje të ngutshme me vendimet tona të ngutshme. Ne nuk guxojmë të subvencionojmë nga buxheti i Komunës OJQ me probleme prandaj deri ta marrim një raport të detajuar nga federata jonë e futbollit mos të marrim këtë vendim meqë mjetet ju duhen kurdo çoftë ose le të deklarohet kryetari ose dikush nga klubi për të cilin e keni sjellë këtë propozim vendim.

Fjalimi u ndërpre nga kryesuesi, meqë nuk jemi tek kjo pikë e rendit të ditës. Ju keni të drejt që jepni propozimin mirëpo nuk keni të drejt me diskutua për këtë pikë të rendit të ditës meqë nuk jemi tek kjo pikë ende.

Labinot Halilaj, unë mendoj që asnjë gjë kundër rregullores nuk beri përkundër i ndërhytë shumë në mënyrë arbitrare, unë edhe tek pika Propozim vendim për krijimin e komisionit i cili do të ndihmojë dhe rekomandojë Kryetarit të Komunës në lidhje vlerësimin e kërkesave të pranuar për dhënie të pronave me negociim ne nëse thojmë që kjo pikë pa arsyetim nuk e di se çka ka kuptim debati edhe parafolësi e dha arsyetimin pse nuk duhet, edhe unë nuk e di

se çfarë komisioni duhet me u themelu kur duhet me qenë pjesëmarrës anëtarët e Kuvendit i cili anëtarët e Kuvendit i ndihmojnë dhe i rekomandojnë, ska nevojë me pas komision prej asambleje nëse duhet me u përdor asambleja për qëllime të kryetarit është çështje tjetër, por për dhëna të pronave janë procedura tjera për dhënie të pronave, aty ku ka të drejt me ju dhënë kryetari prona që ligji ia mundëson për sa ia mundëson atëherë le ta vazhdon ai procedurën vet por jo na me u përdor për qëllime të kryetarit, edhe kjo pike mendoj që është shumë e pa nevojshme.

Egzona Tërdevci, kolegu Halilaj pati plotësisht të drejt kur propozoj që me u shty një pikë dhe është krejtësisht në rregull që me pas arsyetimin pse kërkoj me u shty ajo pikë dhe nuk është që u leshu në fjalim më të gjatë sa e betë ju, pjesa tjetër që e kam ngrit është nuk është në rregull që me ardh propozime një ditë para seance ose ditën e seancës, ne kemi nevoj me i analizua propozimet që i votojmë dhe kërkoj që herëve të tjera kur ta bëni rendin e ditës kujdes me i mbledh krejt çështjet dhe se paku 3 dit ma herët.

Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci, jemi tek miratimi i rendit të ditës, propozimin e bëni me heq ose me lenë në rend dite pikën e caktuar jo me be arsyetimin apo debatin me kry hala pa ja nis dhe me e qit kuvendin në lajthitje, nuk mundeni me ndal zhvillimin e FC "Feronikeli 74" e dyta publikisht dhe ligjërisht e ki ne federatën e futbollit të Kosovës "Feronikeli" është klub i pranuar ka hy ne super lig, po flas për FC "Feronikeli 74" pra "Feronikeli" është edhe i pranun i licencuar për donatorët të cilët dëshirojnë me i ndihmua klubin është për 2023-2024 është i licencuar, ka nevojë urgjente për financim, unë jam i gatshëm piken e rendit të ditës sepse nuk mund të shqyrtohet një pikë e subvencioneve e njëra jo, ose shqyrtohen krejt, ju vendosni a me ju dhënë buxhet apo jo ose nuk votohet asnjë, unë kam të drejt pas kërkesës tuaj me e tërheq piken e rendit të ditës për një muaj, ligji ma lejon me negocu marrëveshje me kompanitë të cilët kanë interes për pronën e komunës, jam i detyruar me i shqyrtu kërkesat e kompanive ose bizneseve të caktuara, unë kam propozu me qenë një komision prej kuvendit me i negocu dhe me i shiku krejt kërkesat dhe me i negocu marrëveshjet me operatorët e caktuar, me kompanitë që kanë interes me e zhvillua pronën në komunën tonë dhe ju keni me dhënë rekomandim nuk keni me e votu keni me dhënë rekomandim, a me marr vendim me e dergu ne kuvend me propozimin dhe negociimin që e bëni ju a mos me e dergu, unë vetëm e kam bërë transparencën ma të madhe, nëse dikush mendon që që e din që nuk ka me qenë në atë komision dhe ta bllokoj edhe këtë çështje është çështje tjetër, prape në dorën e juaj, janë dy kompani gjigante që kane shtrur kërkesa për me investu ne territorin e komunës tonë pra unë ia kam dhënë juve në dorë për me negocu e drejta e kryetarit është me e caktu një trup ose me ia dhënë mundësinë një trupe e cila ka me i negociua çështjet nuk do të thotë që keni me ia dhënë prap e negociatori e sjellni në kuvend i jepni rekomandimet dhe kuvendi vendos "për" apo "kundër" kerkush nuk ju ka detyrua as nuk ju detyron me votu kundër vullnetit të juaj, prandaj pika e 19 mendoj se duhet me mbet ne rend dite. Propozim vendimi për caktimin e lokacionit për realizimin e Projektit për ndërtimin e objekteve kolektive për banim social, ka muaj që negocioj me Liburn Aliu-n Ministrinë e Infrastrukturës të ambientit dhe Planifikimit hapësinor, një zyrtar ne ministrinë në fjalë kë komunikuar me Drejtoreshën Lumniye Krapin, janë 10-12 pika brenda kërkesave të tyre për një momerandum që kemi me e lidh me ata dhe ata kanë kërkuar me e bërë një vendim për caktimin e lokacionit për ndërtesë ose ndërtesa të banimit social dhe atë email e kemi pranuar dje- apo pardje dhe ne e kemi prur vendimin për me kalu në kuvend, a po ia japim lokacioni aty ku është e parapamë me Hartë zonale dhe me plan zhvillimor për banim social në atë pronë a nuk po i japim. Vendimi për alokim të mjeteve të hyrave vetanake ne i kemi tejkalu të hyrat vetanake është mbledhja e fundit që duhet me e dergu sepse ne gusht mundemi mos me mbajt mbledhje, ne fund të shtatorit nëse i qojmë me i aloku të hyrat që i

kemi tepricë, ne nuk mundemi me i zhvillu , dhe nëse ne nuk mundemi me i zhvillu të hyrat jemi të përjashtuar prej çdo gare sepse raporti nuk na del mirë, prandaj e kemi sjellë sot, janë të njëjtat projekte për Drenasin për komunën që i kemi mëndu me i aloku.

Egzona Tërdevci, nuk ke diçka kundër propozimeve vetëm po i marrim vone dhe po na duhet me shumë me i analizu. Ne sot e kemi raporti e KRM "Pastrimi" përveç një letre dy faqe tjerat ishin krejt fotografi, kisha propozu dhe le ta na bjen një raport siç duhet ose për fotografi nuk jemi a njeri prej neve me diskutu, ta shtym për një seance tjetër, le te na sjellë nje raport me te detajuar dhe vazhdojmë.

Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci, ligji ma lejon ne mbledhje me propozu rend dite pavarësisht cila pikë është, nëse shumica e voton duhet me u pajtu me atë çështje, KRM "Pastrimi" dhe KRU "Ujësjellësi" i kemi thirr të dytë me ardh me raportu ne kuvend, ne duhet ta vazhdojmë këtë pikë të rendit të ditës nëse kalojmë në kuvend, zyrtari përgjegjës është këtu, e falënderojmë që ka ardh për me raportu ndërsa ai i kompanisë ujësjellës ka thënë që nuk vij për me raportu. Për mos me zgjat shkojmë më votim dmth për subvencione i tërheqim pikat, për hir të transparencës, ose do të diskutohet të gjitha ose asnjë, komisioni ka propozu ju vendosni a me i dhënë apo jo? Unë jam për me i tërheq gjitha pikat për subvencione prej pikës 9-19.

Labinot Halilaj, ne kur flasim për transparencë ne kemi dhënë prona në shfrytëzim edhe mandatin e kaluar kur kam qenë kryesues, nuk e dina asnjë raport nuk na ka ardh qka u bë me qato prona a janë zhvillu ato projekte, unë mendoj se ky komision për prona është i pa nevojshëm, kjo pikë e rendit të ditës është e panevojshme.

Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci, për pronën e kam edhe obligim ligjor për të bërë raport për pronat që i ka dhënë komuna e Drenasit, raportin e kemi jemi duke u përgatit vedimet për ato prona të cilat nuk e kanë që zhvillu projektin për pronën për çka e kanë marrë dhe kemi bërë rekomandime tjera për ata që nuk kanë arrit me kry, i kemi dhënë afat shtese ku na lejon ligji, në mbledhjen tjetër mund të ia sjellim edhe këtë raport, ku e kemi obligim ligjor me sjellë raport për këtë çështje, për hir të transparencës unë kërkoj që me i propozu anëtarët prej çdo grupi nga një përveç grupi ma i madh i PDK-së i ka për me i propozu dy anëtar, t'i propozoni t'i negoconi krejt marrëveshjet dhe i bina në kuvend, as nuk kam interes personal as një gjë vetëm për transparencë.

Arbër Halilaj, kryetari u drejtua me një gjuhë jo parlamentare duke me quajt i pa ditur, nuk dua më hy ne debate por kërkoj me e tërheq ketë fjalë ofenduese. Unë këtu prezantoj jo persona dhe interesa personale por një subjekt politik, kështu që kërkoj me e tërheq fjalën.

Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci, sa herë nuk ki dijeni të mjaftueshme për diçka që e ngrit nuk kam si te them ndryshe veq se i padijshëm, je i padijshëm për atë çështja që e ki ngrit, pra Kosova në super lig i ka 10 ekipe nja katër ekipe nuk janë as të licencuara prej federatës për me mujt donatoret me i ndihmu pra ata as donator nuk kanë, donatoret të cilët ju lejohet me financu sportin ose gjithçka tjetër që është kulture etj, ndërsa Feronikeli është i certifikuar për vitin 2023-2024.

Arbër Halilaj, unë nuk dua me hy në debat me ketë gjuhë unë mundem me qenë i pa informuar por jam shumë i informuar rrteth klubit gjithashtu do të kërkoj një pikë të veqant për seancat e radhës që kryetari i klubit të vij të raportoj për krejt dallaveret që janë bërë prej kohës të Naser Rames e tutje, FIFA nuk e ka njoft këtë subjekt të ri, emrin mundesh me i bo

si të duash por kjo është “Feronikeli” jo “Feronikeli 74” dhe meqë po insiston me vlersu dijen e dikujt kryetari unë nuk marrë pjesë në këtë seancë.

Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci, je duke i mashtru edhe opinionine dhe asamblastët por nuk mundesh me e mashtru askënd FIFA as nuk ka thënë që e njeh as si nuk e njeh, federata e futbollit të Kosovës kur e lejon nuk guxon Federata me leju diçka që ia refuzon FIFA, mos e mashtro qytetarin e Drenasit e as asamblastët. Gjuha ime është shumë parlamentare.

Pas këtyre diskutimeve kryesuesi hodhi në votim rendin e ditës: prezent gjatë votimit ishin 29 anëtar, **(Për)** votuan 26 anëtar, 3 kundër, abstenim nuk pati, u miratua rendi i ditës me tërheqjen e pikave nga pika 9 deri tek pika 19 me kërkesë të asamblesë dhe kryetarit Propozim Vendimet për financimin për projektin e OJQ-ve. Arbër Halilaj lëshoj seancën dhe nuk u kthye më në seancë.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal, Milaim Hajdari- hapi diskutimin për pikën e parë të rendit të ditës: **1. Procesverbali i mbledhjes së rregullt të KK i mbajtur më dt. 29.06.2023.**

Meqë nuk pati diskutime vërejtje apo sugjerimeve kryesuesi hodhi në votim këtë pikë të rendit të ditës: prezent gjatë votimit ishin 29 anëtar, **(Për)** votuan 28 anëtar, kundër nuk pati, 1 votë abstenim, u miratua procesverbali i mbledhjes së rregullt të KK i mbajtur më dt. 29.06.2023.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal, Milaim Hajdari- hapi diskutimin për pikën e dytë të rendit të ditës: **2. Informim i Kuvendit Komunal për aktivitetet e Këshillit Komunal Për Siguri në Bashkësi.**

Nuk pati diskutime sa i përket kësaj pike te rendit të ditës.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal, Milaim Hajdari- hapi diskutimin për pikën e tretë të rendit të ditës: **3. Propozim vendim për miratimin e Kërkesës, Nr. 06-070/01-19409,dt:25.04.2023,për ndihmë financiare për mjekim të sëmundjes me diagnozë: Aneurisma A-basilaris, SAH dhe HIC, në shumën totale prej 3,000.00 euro.**

Meqë nuk pati diskutime vërejtje apo sugjerimeve kryesuesi hodhi në votim këtë pikë të rendit të ditës: prezent gjatë votimit ishin 28 anëtar, **(Për)** votuan 28 anëtar, kundër nuk pati, abstenim nuk pati, u miratua **Propozim vendim për miratimin e Kërkesës, Nr. 06-070/01-19409,dt:25.04.2023,për ndihmë financiare për mjekim të sëmundjes me diagnozë: Aneurisma A-basilaris, SAH dhe HIC, në shumën totale prej 3,000.00 euro.**

Kryesuesi i Kuvendit Komunal, Milaim Hajdari- hapi diskutimin për pikën e katërt të rendit të ditës: **4. Propozim vendim për miratimin e kërkesës , Nr. 01-070/34686 dt. 18.07.2023 për ndihmë financiare për mjekim urgjent të sëmundjes me diagnozë Eëing Sarcoma reglumbalis, në shumën totale prej 2.790 euro .**

Meqë nuk pati diskutime vërejtje apo sugjerimeve kryesuesi hodhi në votim këtë pikë të rendit të ditës: prezent gjatë votimit ishin 28 anëtar, **(Për)** votuan 28 anëtar, kundër nuk pati, abstenim nuk pati, u miratua **Propozim vendim për miratimin e Kërkesës, Nr. 06-070/01-19409,dt:25.04.2023,për ndihmë financiare për mjekim të sëmundjes me diagnozë: Aneurisma A-basilaris, SAH dhe HIC, në shumën totale prej 3,000.00 euro.**

Kryesuesi i Kuvendit Komunal, Milaim Hajdari- hapi diskutimin për pikën e pestë të rendit të ditës: **5. Raporti i Auditimit për pasqyrat Financiare vjetore të Komunës së Gllgovcit për vitin 2022.**

Egzona Tërdevci, vet fakti që zyra kombëtare e auditimit ka dhënë një raport të kualifikum për pasqyrat financiare për Komunën e Drenasit për vitin 2022 kjo tregon se nuk ka pas menaxhim të mirë financiarë e as planifikim të mirë përgjatë këtij viti, janë gjithsej 9 gjetje nga raporti i auditimit por për mua më shqetësues janë tri nga këto, gjetja e dytë që janë kryer pagesa për punë të pakryera për gjatë vitit 2022 janë pagu 95,664 € për punë ende të parealizuar këto pagesa janë bërë ndërtimin e stadionit të qytetit, fushat sportive dhe rekreacion, kërkoj një sqarim se pse janë kry pagesa për punë që ende nuk janë kry dhe a është evitua ky problem vitin 2023. Shqetësimi tjetër është ndryshimet prej 10 % të vlerës së kontratave pa aplikuar procedurat e prokurimit, janë ndryshuar sasisë e realizuara në pozicionet e caktuara të cilat janë aprovuar kryesisht nga zyra e prokurimit dhe kryetari pa aplikimin e procedurave të prokurimit, kjo dukuri është evidentuar tek disa kontrata është ndërtimi i stadionit, rehabilitimi dhe rikonstruimi i rrjetit të kanalizimeve në komunën e Drenasit, si dhe ndërtimi i kapacitetit të ujësjellësit në Drenas ku janë ndryshuar 43 pozicione apo 27 % të vlerës së kontratës kur e dina që me ligj të prokurimit vetëm 10 % mund të ndryshohet, cila ka qenë nevoja që të ndryshohen këto pozicione pa i ndjek procedurat dhe rregullat e prokurimit dhe pse nuk janë planifikuar me kohë mirë këto projekte. Gjetje tjetër është angazhimi i stafit sipas marrëveshjen për shërbime të veçanta për pozita të rregullta të punës, ju e dini që për pozita të rregullta hapet procedura të rekrutimit dhe nuk është në rregull që me procedura të prokurimit të angazhohet staf i cili kryen punë të përditshme të komunës, kërkoj sqarim për këto çështje.

Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci, shqetësimi i Egzones, pagesa për punë të pakryera e keni fq 8 sqarimin e zyrtareve, punët janë kry dhe janë dhënë sqarimet. Çështja A1 pagesa për punë të pakryera paragrafi i parafundit ku thotë menaxheret e kontratave na kane siguruar dëshmi se punët kane filluar të realizoheshin pas ekzaminimit fizik, ndonëse gjatë kohës sa ishim në ekzaminimit të auditimit deri më 28.04.2023 punët ende nuk ishin përfunduar, kjo dmth që nuk kanë qenë duke u zhvillu punimet, megjithatë komuna na ka siguruar dëshmi kanë qenë fizikisht më dt. 8.06.2023 se tashme punët ishin realizuar sipas kërkesave të kryera, tani shkaku i pagesave për punë të pakryera ishte mos lejimi që mjetet buxhetore të shkonin suficit, është rekomandim në rregull i zyrës kombëtare të auditimit dhe ne jemi të detyruar me i zbatu, tek ndryshimi i pozicioneve zyrtaret e prokurimit deri në fund të nëntorit, rregullorja deri në 30 % munden me ndryshu pozicionet të cilat kërkohen me pozicionet që janë në kontratë më çmime brenda vlerës së kontratës, në dhjetor ka ndryshu rregullorja u kanë 14 % u ra në 10 % është një ndryshim prej 4 % ne dhe zyrtaret jemi të gatshëm me u përgjigj para çdo institucioni tjetër relevant në Kosovë.

Kamer Rama- Auditor i brendshëm, sa i përket angazhimit të stafit me kontrata të veçanta dua të theksoj një çështje që ajo është një formë e lejume me ligj, ne e kemi bërë atë me proces të prokurimit ashtu siç kërkohet, por çështja e auditorëve ka qenë në theksin se ata punëtor të angazhuar me kontrata të veçanta i kryen punët që duhet t'i kryenin punëtorët e rregullt, pse na nuk i kemi pas këta punëtor të rregullt por i kemi angazhu me kontrata në vepër është çështja e kufizimit të stafit dhe kufizimit të buxhetit, ata nëse angazhohen përmes kontratave në vepër paguhet prej mallra dhe shërbime, ndërsa si punëtor të rregullt paguhet prej pagave dhe mëditjeve ku kemi kufizime dhe në staf, numri nuk ka qenë 6 por 4 mirëpo ata e kane evidentu 6 sipas llogarisë të tyre për arsye se kemi të drejt me i angazhu ata në një periudhë deri në gjashtë muaj që dmth brenda vitit i njëjti vend i punës duhet me u zgjedh

punëtori tjetër dy here dhe ata e kanë numëru 6 mirëpo dy prej tyre kanë kalu si punëtor te rregullt.

Mehedin Salihu, shumë njerëz e kanë realizuar të drejtën e vet përmes përmbaruesve privat pse po vjen deri tek kjo gjendje kur e dina se nuk kemi qare pa i pagu.

Kamer Rama- Auditor i brendshëm, këtë çështje e kemi diskutua po na kushton shumë ma tepër se sa ato mjete që po i marrin qytetaret tanë, edhe këto pagesat klektive nuk po shkojnë dikun tjetër tek qytetare tanë mirepo është evidente një përqindje shumë e madhe e këtyre mjeteve po shkon për vendime përmbarimore shpenzime te gjykatave etj për të gjitha këto po ngarkohet komuna.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal, Milaim Hajdari- hapi diskutimin për pikën e gjashtë të rendit të ditës: **6. Raporti i Auditimit për pasqyrat Financiare vjetore të Komunës së Glllogovcit për vitin 2022.**

Shyqeri Bublaku-Drejtor i Financave, sa i përket raportit financiar janar-qershor mund te themi se te hyrat kemi një tejkalim të planit vjetor te hyrave që është ne parametrat e dëshirueshëm sa i përket kësaj periudhe, sa i përket shpenzimit të buxhetit jemi me përqindje bukur të mirë të realizimit të buxhetit edhe pse ka pengesa.

Egzona Tërdevci, në shpenzimet kapitale tek Drejtoria e Infrastrukturës Publike nga Lista e projekteve vetëm gjashtë projekte janë realizuar plotësisht ndërsa gjashtë projekte nuk kanë fillu fare, si është çështja me projekte tjera kur e dina që në gjashtë mujorin e fundit mundësitë për me i realizu projektet mundem me kanë ma të vogla për shkak të kushteve atmosferike në tre mujorin e fundit, tek shëndetësia ka nis vetëm një projekt ka shpenzim ndërsa për asnjë projekt tjetër nuk ka dhe ajo është për blerje të autoambulancave, tek drejtoria e kulturës është vetëm një projekt i realizuar dhe tek drejtoria e arsimit nuk ka asnjë projekt kapital që ka shpenzime, kur po mendoni me i shpenzua këto projekte kapitale?

Shyqeri Bublaku-Drejtor i Financave, sa i përket raportit të investimeve kapitale, periudha e parë e vitit 2023 gjegjësisht edhe periudha kohore të cilën e kemi kalu duke marrë parasysh edhe kohën e cila ka ndiku bukur shumë, si shumë ne kemi bërë një shpenzim bukur të madh në periudhën gjashtë mujore mirëpo nuk duhet te jemi te kënaqur sepse edhe koha kushtet atmosferike kanë ndikuar që shumë projekte mos të mundën të vazhdojnë, kemi projekte që janë në prokurim dhe do të vazhdojnë zhvillimin e tyre mirëpo kjo është sa i përket periudhës janar-qershor. Projektet tjera janë duke u zhvillua.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal, Milaim Hajdari- hapi diskutimin për pikën e shtatë të rendit të ditës: **7. Raporti i kompanisë KRM "Pastrimi."**

Egzona Tërdevci, paraprakisht kërkova me e heq si pikë nga rendi i ditës, për shkak te kohës se shkurt që e kemi pranë raportin dhe raporti realisht nuk ka diçka përmbajtjesore, unë nuk mundem me diskutua përderisa nuk kemi material për çka me diskutu.

Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci, edhe në KPF dhe ne mbledhjen e kaluar e kemi diskutuar që do ti thërrasim kompanitë me raportu kompania ka me raportu aq sa ka materiale, e falënderoj drejtorin e kompanisë KRM "Pastrimi, që është prezent.

Labinot Halilaj, nëse kompania është thirr për raportim behet nje here raportimi pastaj bëhet debati.

Drejtori i Kompanisë **KRM "Pastrimi- Kastriot Berisha**, Rrethanat të cilat jemi duke u ballafaquar si kompani regjionale dhe vëllimi i madh i mbeturinave që po largojmë në Komunën e Drenasit është duke u përmirësuar dukshëm, në shtrirjen e kemi deri në 97 % me përjashtim të disa rrugica na duhet të shkojmë shumë larg për grumbullimin e mbeturinave, rast të tilla kemi në Nekoc, Terstenik, Gradice dhe Gjergjicë. Ne jemi mirënjohës pushtetit lokal për ndihmë. Ne tani operojmë larg me mirë se vitin e kaluar, me 5 kamionë, ku për fat të keq vitin e kaluar i kemi pas vetëm 2 kamionë, ku punojmë në 20 orë në ditë. Vlen të theksohet se tani kemi 4 kamionë të ri, ku operimi dhe menaxhimi i mbeturinave për ne është dukshëm më i lehtë. Gjithsesi duke falënderuar qytetaret të nderuar për mirëkuptim. Komuna e Drenasit po ashtu sivjet na ka ndihmuar direkt me një infuzion teknik (Kontiniere 7 m³) çka për ne ishte të hyra financiare me shumë, na keni ndihmuar gjithashtu me dy kontejnerë 17 m³ piken e transferit, atje tani me veç se është pastruar në tërësi. Në këtë tremujor kemi pak ngecje në inksim si KRM Pastrimi në të gjitha komunat në regjion duke përfshirë edhe Drenasin po ashtu.

Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci, nevojat dhe kërkesat e kompanisë që janë për buxhetin nga Komuna e Drenasit me i ndjek dëgjimet për me pas mundësi me i bërë kërkesat dhe me i impliku për vitin e ardhshëm në buxhet me i miratu, sa i përket asaj që e këtë 180 m duhet me shku me marrë kontejnerin është e saktë sepse kamionët tani janë me të mëdhenj dhe në prona private ne nuk i kemi asfaltu ende sepse nuk kemi të drejt, mirëpo qytetaret është mirë me i sjellë deri aty dhe me pas ju me të lehtë.

Mehedin Salihu, e përgëzoj për punën sepse ka përmirësime pozitive, mirëpo pyeti pse kjo kompani nuk e ka lirua prej pagese asnjë kategori as kategoritë sociale, as veteranet as familjet e invalidëve?

Drejtori i Kompanisë **KRM "Pastrimi- Kastriot Berisha**, sa i përket kësaj pyetje nuk mund të përgjigjem realisht sepse kemi shumë faturim të dyfishtë që është bërë si mungesë e informacionit nga ata, dhe janë bërë lëshime që edhe ne kemi dal keq, nuk kemi qasje në këtë raport.

Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci, mbi 1500 familje me asistencë sociale kompania i merr mbeturinat pa pagesë, kompania ka kërkuar prej kryetareve të komunave të regjionit të Prishtinës me e rrit çmimin e mbeturinës e vetmja komuna jonë nuk e ka ndryshu, a kanë nevojë me e rrit është e arsyeshme mirëpo si komunë me e kushte me të renda ekonomike nuk kemi pas mundësi të veprojmë ndryshe.

Albulena Saliuki, shihet një përmirësim në menaxhim të mbeturinave dhe kisha kërkuar shumë që me vazhdu me këtë ritëm dhe me qenë korrekt me gjithë qytetaret e Drenasit. Pyeti rreth inkasimit pse ka ngecje dhe cilat janë arsyet kur do të fillojnë punën rregullisht inkasantët meqenëse qytetaret kanë nevojë që të informohen.

Drejtori i Kompanisë **KRM "Pastrimi- Kastriot Berisha**, sa i përket inkasimit ka ramje në të gjitha komunat e regjionit të Prishtinës, inkasantët e kanë për detyrë, mirëpo për momentin nuk kemi veturë dhe me veturën time personale shkojnë edhe i shkepin faturat çdo dy muaj i bien në secilin fshat.

Beqir Kiqina, pyeti: a keni marrë masa dhe a është e gatshme që kjo kompani të operoj edhe gjatë sezonës të dimrit me të njëjtin kapacitet sikurse edhe tani, sepse gjithë e dina që gjate dimrit për shkak të kushteve atmosferike vështirëson edhe qarkullimin të makinerisë tuaj që e keni në dispozicion.

Drejtori i Kompanisë **KRM "Pastrimi- Kastriot Berisha**, ne duhet te mundohemi mirëpo dimrit për shkaqe teknike të kamionëve janë komplet ndryshe krahasuar me verës.

Gani Krasniqi, e ceket që do ta bëni riciklimin, në çfarë forme keni mëndu ta bëni riciklimin e mbeturinave?

Drejtori i Kompanisë **KRM "Pastrimi- Kastriot Berisha**, ne do të vazhdojmë me atë projekt siç ka qenë më herët por duke marrë për bazë anën teknike që e kemi pas të shkatrume ose në raport me piken e transferit nuk kemi mujt me pas riciklim sepse riciklimi e donë një hapësirë, ne do të vazhdojmë me atë dhe do ta zgjerojmë me infrastrukturën teknike që e kemi tani këtu edhe me lagjet e tjera, ajo do të vazhdojë në të njëjtën ritëm edhe duke vazhdua edhe me lagjet e tjera.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal, Milaim Hajdari- hapi diskutimin për pikën e tetë të rendit të ditës: **8. Propozim vendim për ndryshim-plotësimin e rregullores për Taksa, Tarifa, Ngarkesa dhe Gjoba.**

Agnesë Bucolli-Drejtoreshë për Zhvillim Ekonomik- Pas raportit të Zyrës Kombëtare të Auditorit, Prishtinë Qershor 2023 në çështjen 4 - A 2, respektivisht rekomandimin Nr.4 – A 2, kërkohet nga ana e kryetarit të komunës që të bëjë plotësim Plotësim ndryshimi i Rregullores Nr. 12 Nr.400-16587 të dt. 27.05.2020.

Ndryshohet Neni - 13.5.5 Drejtoria për zhvillim Ekonomik shpërndarjen e faturave do të bëjnë gjatë vitit fiskal dhe tarifën sipas këtij ndryshim-plotësimi do të vlejë nga viti 2023.

Ndryshohet - Neni 20.3 dhe 20.4

Plotësim ndryshimi i tarifave mujore në QEAP "Ardhmëria" Drenas, konkretisht tek çmimi; tek Neni 20.3 (shuma prej 59 € duhet të jetë 55 €) dhe neni 20.4 (shuma prej 69 € duhet të jetë 65€). Gjithashtu është edhe pika tjetër në këtë propozim vendim por është nga drejtoria e arsimit aty është vec nje gabim teknik i cili ka ndodhur gjate bërjes se rregullores e keni vec mbledhjen nëse ka diçka drejtori mundeni edhe ju por vec nje gabim teknik qe ka ndodh.

Florentina Elezi- Unë i kam disa paqartësi, a muajna me propozu ndryshime për tarifën për bizneset ndryshe ose veprimtari ndryshe qetash për qetash ktu se ma keni pshtjell diçka..

Kryetari i Komunës Ramiz LLadrovci: Na jemi duke i bërë vetëm disa ndryshime emergjente që jena të obligum me harmonizim ajo e sjelli një shembull, shembull unë nuk ka, drejt me folë me emra po po e tham, HIB PETROLI Komoran ose Korroticë si quhet ajo e ka të baravlefshme funksionimin ose vec ma shume veprimtarin se sa SHELLI apo FER PETROLI apo kompanit tjera që janë në një rrugë tbarabart po kompania HIB PETROLI pagun takse 200 euro takse të operimit ndërsa kompanit tjera të derivateve pagujn 4000 nese sgaboj ose 2000 euro nuk e di përmendesh 2000 euro pra është .. Na po dojmë me i barazu kto e masasne kur të shkojmë proces se unë e kam pas kërkesa për ndryshimin e rregullores si dhe ato kur të shkojnë në proces të përgjithshëm ajo bohet me komision neve auditori na ka ka lyp me urgjenc sepse na nuk muajna me faturu për diçka që nuk e këna rregullu me rregullore edhe për arsim është një tarif ven me ka 55 euro 65 euro nëse spo gaboj 4 euro e diçka është dallimi nqata.. se kane ba hala ata.. jo jo ska të beje...

Agnese Kastrati Bucolli: Po e marr edhe nje shembull te avokatura në Drenas ka shumë avokat që punojnë si avokat por nuk kanë kod ne si drejtori e kemi ngarku me takse vetëm një avokat për këtë arsye kemi kerku ne mënyrë sa me te shpejt me ba këtë propozim vendim sepse nuk kane kodin e veprimtarisë e për mos me ba dallimi ne biznese kërkojmë qe ne baze te kodeve mej tarifu edhe bizneset tjera edhe nëse nuk janë ne rregullore.

Beqir Kiqina: Te kodet a ka mundësi një pyetje se nuk e pata të qartë, qëllimi është kështu nëse një biznes funksionon me me shume se një pike i ka dy tri pika për secilën pike a duhet me pas kod te veçantë dmth biznesi apo mjafton po e zëmë shembull një biznes edhe pse i ka dy ose me shume pika e ka vetëm një kod buxhetor, faleminderit.

Kryetari i Komunës Ramiz LLadrovci: Beqir çdo veprimtari ku e zhvillon pagun takse operimi po flasim për takse operimi komunale nuk ka rendësi se a i ka dy biznese a tri çdo njanen e ka obligim për qeta po dojna me i harmonizu pra cdo njani qe i ka te njëjtën veprimtari me pagu njejt në bazë të pozicionit se ajo pozicionet ndryshojnë, na psh kemi taksen, cila takse është te ju ajo që e pagujmë 10 euro, po, sikur për 50 pagujn njejt nuk është e drejt pra na qeto po i rregullojnë.

Mehedin Salihu: Unë edhe Drini jena ka anëtar te komisionit qe hale edhe Valentina kerkoje falje Valentine per harrese edhe mesap kryetari tha qe hala se ka perfundu drejtoresha projekti final?Po. Po. Po. Une dashta vec qetu me ja rikujtu drejtoreshës ni kerkese koka edhe kryetari ktu, shume qendra tjera bre smerren me kete pune hic i kane liru bizneset, gjendje me te ran se bizneset e Drenasit sbesoj qe ka naj komune tjetër kshu qe ta kem parasysh tju ndihmojmë pak ti lirojmë edhe ata jo per patriotizëm po per fjale e kam jemi per cdo dite po ai per atu ma ski cka ndryshon, vec kur vjen nkuvend ke me qu dorën sikurna haha, vetëm te përfundoj fjalën Kryetar, nuk po du me ka modest ne fjale po thash ta kem parasysh masi u qel kjo tem, bizneset i këna ne gjendje te veshtire ti lirojmë prej obligimeve komunat tjera qe janë ndashta edhe me te varfura se na i kane tllirun, drejtoresha eshte ne dijeni. Po qeto qe i kem na nuk kem fort biznese tmdhaja qe mi pas NIKLIN e ato spo tham une biznese qe i kem aktuale aktive qe janë lodh me dek ata janë buze falimentimit bile tja lirojmë qet barre, plus drejtoresha e kem e kam pa nhartim nashta po dal prej konteksti po per hire te opinionit kem grumbullim te tatimeve shume tborqeve shume na si komision e këna parapa e këna ba nje kerkese me ja fal atyne .. po de si propozim.. ta kemi parasysh edhe qeta se ja nimon ose bili edhe mos tja falshum krejt ½ me pagu ti ngjallum pak ti nimojme pak, falemimderit kryetar.

Kryetari i Komunës Ramiz LLadrovci: Falja e taksës se operimit është e pamundshme për bizneset, çdo biznes që vepron në komunën e Drenasit, e ka një taksë të operimit e arsyeshme për operimin që e bënë pra në qofte se një pom benzini nrrugen Ibrahim Rugova nkomoran e qun takse te larte nje takse prej 2000 eurove ne vjet atëherë e kemi gabim se mbi bazene e taksave na inkasojmë te hyra per investime kapitale në komunën tone se ato nuk i qojmë diku tjetër edhe bizneset tjera bizneset ose bizneset e vogla qe janë na i këna te falne disa biznese te vogla nuk takse operimi janë te ndame une e kuptoj cka asht kërkesa per opinionin edhe po ata nuk mujna me ba sepse na jena me fal taksen pastaj tviteve tjera na nuk këna drejt qeveria mun me fal ose mun me na jena te detyrun me zbatu na edhe ne raport te auditorit dalim keq kur inkasojmë ma shume per shkake qe inkasojmë borqe sepse ne raport thot qe duhet me i inkasu mrena vitit me kohe dikush se pagun dikuj ja qojn me vonese dikuj na jena te detyrun me inkasu po ne raport dalim keq sepse nuk këna gene as na dmth krye detyrës po as qytetari nuk e ka pagume kohe taksen tu munu me ike edhe pi mashtrojmë njerzit kur po i thojme ti falim se ai ma spo vjen me i pagu tu prit qe po i falet e po i shtohet aja kshu qe mos e bani

ka sepse nuk kam drejt me fale kur te sjelli une kuvend mundeni me fale ose mos me fal po ju nuk muneni me propozu me fal taksës sepse mbi bazën e taksës ne i bajm me planifikimet vjetore nëse na i këna ba planifikimet ju nuk muneni me hjek ate bugjet sepse na nuk mujna me zhvillu projektin per qytetaret e komunës sonë.

Mehedin Salihu : Nuk është nuk është çështja atu siç po e pozon ti kryetar, kërkesa e jem personale po nisna unë është e arsyeshme do domethënë nuk ka vija politike kurrfarë as une po kerkoj me ju ndihmu edhe ma merr mendja qe krejt asambleistat janë për me i ndihmu bizneseve as një biznes nuk e kam unë temin kështu qe t'ia hjeku unë atë ngjyrën politike unë jam per me ju ndihmu e kam pa ne raport per qeta ju drejtova drejtoreshës qe janë shume borgje te akumulune edhe qato borq ska mundësi bizneset me i pagu nëse na i detyrojmë me përmbarues ata këna me i mbyt krejt çështu është kërkesa jem për qeta thash a mujna na me ju ndihmu edhe na jem qeverisje lokale unë nuk po kërkoj prej qeverise qendrore po prej qeverise lokale kaq.

Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci: Na ne kohen e pandemisë i këna fal këto taksa edhe i kemi kry si mision, çdo kush qe s'munet me pagu taksen qe është biznes i vogël na i këna subvencionu ata jo veç qe i këna denu ka tri vjet qe nuk pagujne bizneset qe e nisin biznesin nuk pagujn takse komunën tone edhe na i këna letu i këna kriju i këna hap mundësit na smujm ja majm gjalle biznesin nëse ai ka me pagu 70 euro ne vjet apo 80 euro nëse për 80 euro ka met një biznes atëherë se kuptoj qysh këna me ja majt ata na nuk mujna mijëra euro qe i kane ata kane zhvillu biznes kane edhe jena detyrun me njek me ligj na po kërkojmë me votu këto propozim ndryshimet e domosdoshme te kërkojnë nga auditori i brendshëm i komunës tone.

Meqë nuk pati diskutime vërejtje apo sugjerimeve kryesuesi hodhi në votim këtë pikë të rendit të ditës: prezent gjatë votimit ishin 27 anëtar, **(Për)** votuan 27 anëtar, kundër nuk pati, abstenim nuk pati. U miratua kjo pikë e rendit të ditës.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal, Milaim Hajdari- hapi diskutimin për pikën e njëzet meqë pikat e tjera u tërhoqën nga rendi i ditës: 20. **Propozim vendim për krijimin e komisionit i cili do të ndihmojë dhe rekomandojë Kryetarit të Komunës në lidhje vlerësimin e kërkesave të pranuar për dhënie të pronave me negocim.**

Ju e keni 19 te unë është 20 se 1 pike nuk është ka në ftese po u hi tutje u deshtë me ka ne ftese është vonu nuk u hi po sidoqoftë, jena te propozim vendim për krijimin e komisionit i cili do te ndihmoj dhe rekomandoj kryetarit komunës me lidhje me vlerësimin e kërkesave te pranuar për dhënien e pronave me negocim dmth u diskutu, shkojna me propozimet e grupeve parlamentare, komisioni është prej 9 anëtareve propozim vendimi është që grupi i PDK përfaqësohet me 2 anëtarë ndërsa subjektet tjera me nga 1 anëtar edhe nja ke prej OJQ-se një prej ekzekutivi, atëherë shkojmë me rend prej grupeve parlamentare.

Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci: Unë për ekzekutivin e propozoj nënkryetarin e komunës Arben Shala dhe prej OJQ-se znj.Kadire Tahiraj.

Bekim Lestrani: Përshëndetje, grupi i PDK-së eshte dakordu që me propozu Bekim Lestrani dhe Albulena Saliuku.

Milaim Hajdari: Bekimi dhe Albulena prej PDK-se.

Mehedin Salihu: Ne mungese të shefes se grupit e propozojmë profesor Hamit Haxhiun NGA Subjekti i DD.

Milaim Hajdari: Vetvendosja?

Egzona Terdeci: Prej grupit te lëvizjes Vetëvendosje propozojmë Florentina Elezi Veliun .

Milaim Hajdari: shkojna me AAK-ne?

Beqir Kiqina: Na dmth përfaqësohemi me një asamblist dhe pranoj që të jem pjesë e këtij komisioni.

Egzon Qorri: Jo se jemi vetëm nja dhe unë pranoj të jem pjesë e komisionit.

Milaim Hajdari: Komisioni përbehet prej një ekzekutivi Arben Shala prej shoqërisë civile Kadire Tahiraj, prej asamblesë komunale Bekim Lestrani, Albulena, Hamit Haxhiu, Florentina Elezi, Beqir Kiqina, Egzon Qorri, shkojmë me votim kush jeni për këtë.

Meqë nuk pati diskutime vërejtje apo sugjerimeve kryesuesi hodhi në votim këtë pikë të rendit të ditës: prezent gjatë votimit ishin 26 anëtar, **(Për)** votuan 23 anëtar, 3 kundër, abstenim nuk pati, u miratua kjo pikë e rendit të ditës.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal, Milaim Hajdari- hapi diskutimin për pikën e njëzetënjë **21. Propozim vendim për rritjen dhe bartjen e të hyrave vetanake.**

Meqë nuk pati diskutime vërejtje apo sugjerimeve kryesuesi hodhi në votim këtë pikë të rendit të ditës: prezent gjatë votimit ishin 29 anëtar, **(Për)** votuan 23 anëtar, 3 kundër, abstenim nuk pati.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal, Milaim Hajdari- hapi diskutimin për pikën e njëzetedy **22. Propozim vendim për caktimin e lokacionit për realizimin e Projektit për ndërtimin e objekteve kolektive për banim social.**

Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci: nje sqarim, na po e cekim per objektet e banimit social qe nënkupton me shume se nje objekt per sqarimin e juv me ministrin Liburn Aliun kemi diskutu për dy objekte me sekretarin e ministrisë z.Servet Spahiu nëse s'gaboja fole për një objekt që të jemi të qartë na si komune jena te gatshëm me i ofru lokacionin dhe pronën komunale për ndërtimin e dy e me shume objekteve pra po ju kërkojmë me votu për objekte pra pa percaktu se sa objekte ka mundësi me i ndertu ministria e infrastrukturës ambientit dhe planifikimit hapësinor aq ka prone te na qe mos me ardh dy here tri here ne votim unë po ja kërkoj me votu unë besoj edhe ne Florentin edhe me ty mdoket këna fole qe ka than Liburni dy objekte unë besoj qe dy i bajn sepse jena komuna qe me se shpejti i këna dha përgjigje dhe besoj qe ka me i zhvillu procedurat për dy objekte pra po kërkojmë ato i këna edhe si zone po thuajse është zone ne harte komunale ne harte është e parapan banim social dhe tjera kështu qe s'kemi asnjë pengese ligjore ne këtë aspekt, faleminderit

Labinot Halilaj: Faleminderit kryesues , dmth jemi duke fole per 43 ari për afërsisht , pak a shume , dmth eshte ne pyetje 43 ari in shaa Allah bahet em u ndertu edhe 4 se nuk e kontestova, atëherë po pse jo edhe per 2 edhe per 2 pse jo nketë rast eshte mire me votu.

Meqë nuk pati diskutime vërejtje apo sugjerimeve kryesuesi hodhi në votim këtë pikë të rendit të ditës: prezent gjatë votimit ishin 27 anëtar, (Për) votuan 27 anëtar, kundër nuk pati, abstenim nuk pati.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal, Milaim Hajdari- hapi diskutimin për pikën e njëzetetë
23. Plani i veprimit për implementimin e rekomandimeve të raportit të auditorit.

Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci: para vetes e keni edhe planin e implementimit të rekomandimeve të auditorit përgjithshëm na e këna obligim mrena 30 dite me e miratu planin e implemenitimt na e këna miratu e kena njoftu auditorin e përgjithshëm por e këna obligim me e qit ne diskutim nëse ka dikush me diskutu rreth planit implementimit rekomandimeve ne jena te detyrun me dhënë sqarime aq sa dimë aq sa mujm se për sa kohe mujm me i implementu këto rekomandimeve e keni per cdo rekomandim e keni afatin e rekomandimeve ka rekomandime qe veç janë zbatu kjo eshte pak a shume nuk votohet po ish dashtë me kane bashke me raportin e auditorit meqenëse nuk ka hi ne komitet e këna diskutu qe këna me shti e kemi shti si pike te rendit te ditës nuk votohet por diskutohet.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal, Milaim Hajdari- hapi diskutimin për pikën e njëzetekatër
24. Të ndryshme.

Egzona Tërdevci: unë e kam një kërkesë prej banoreve të Nekocit është një pjese për juve qe e njihni Nekocin është një pjesë të “gryka e Gashit” është peizazh i bukur natyror qe kane qendru shumë refugjat dhe njerëz gjate kohës se luftës, deputeti nga lëvizja vetvendosje Enver Dugolli i cili vjen nga ai fshat ka bisedu me ministrin Liburn Aliun mundësin për shndërrimin e asaj pjese ne park ku do te mbilleshin druje natyror edhe do te bëheshin investime tjera, ministri është zotu qe e mbështet si projekt vetëm se ka nevojë projektin me ba komuna, unë publikisht po ju kërkojë mbështetje si komune për me e ba një projekt te tille detajet mundeni me i diskutu qofte me ministrin apo deputetin unë vetëm e përcjella si kërkesë.

Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci, e keni edhe në plan të zhvillimit të komunës tonë, jemi në proces te ndërtimit të kanalit apo rrjedhjes e ujit siq e kemi bërë edhe në fshatin Kishnarekë, ju e dini qe nuk kemi kompani për ta bere një kompani te tillë, meqë ka shpreh vullnet edhe ministri e kane edhe kompaninë ata mund ta angazhojnë një kompani, meqë ne nuk kemi kompani, e falënderojmë ministrinë dhe le ta bëjnë projektin deri në fund.

Hamit Haxhiu, është një kërkesë e fshatit Shtrubullojë e dt. 24.05.2023 për rrugën “Burim Sahiti” vetëm është grry para zgjedhjeve dhe është bërë e pakalueshme, a i keni kthyer përgjigje kësaj kërkesë?

Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci, kur ta boni një kërkesë duhet me ditë a është pronë publike apo pronë private? Çdo kund ku kemi shtru zhavorr jemi në proces të shtrimit të asfaltit, mirëpo aty ku nuk jemi në proces ku rruga është private ne nuk guxojmë me shtru asfalt mirëpo zhavorr mundemi.


Gani Krasniqi: respekt për deputetin që ka kërku me ndërtu një park ne gryken e Nekocit mirëpo si nuk ju ka kujtua me edhe për gryken e Kishnarekes.

Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci, unë i gëzohem çdo investitori që investon në komunën tonë

Meqë nuk pati diskutime tjera kryesuesi e konsideroj të mbyllur seancën, seanca përfundoj rreth orës 12:40 min.


Me gjerësisht, mbledhjen e rregullt të Kuvendit të Komunës së Drenasit të datës 27.07.2023 mund të ndiqni në ueb faqen zyrtare të komunës, rrjetin social të Facebook-ut dhe në kanalin YouTube.

Procesmbajtëse:


Liridona Fejza-Ajazi



Kryesuesi i Kuvendit Komunal


Milaim Hajdari



Republika e Kosovës
Komuna e Drenasit

Zyra e Kryetarit

Nr. 01 - 432/02 - 41249 dt. 21/08 /2023



Në bazë të nenit 58 par. 1 pika h të Ligjit nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 72.2 paragrafi (a) të Statutit të Komunës së Drenasit, Kryetari i Komunës së Drenasit, propozon: që në bazë të nenit 11, të nenit 12, pika 12.1 dhe pika 12.2, nenit 14 pika 14.1 dhe nenit 40 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, Neni 5 Kapitulli II/A I Ligjit Nr.08/L-224 Për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit NR.06/L005 për Tatimin në Pronën e Paluajtshme, Kuvendi i Komunës së Glllogocit në mbledhjen e mbajtur me datë _____ 2023 të miraton këtë:

PROPOZIM - VENDIM

Për faljen e tatimit në pronë për vitin tatimor 2023

I.

TË MIRATOHET propozimi - vendimi për për faljen e tatimit në pronë për vitin tatimor 2023, i cili rrjedhë nga Neni 5 Kapitulli II/A, Neni 11/B paragrafi 2 i Ligjit Nr.08/L-224 Për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit NR.06/L005 për Tatimin në Pronën e Paluajtshme.

II.

Qëllimi i këtij propozim - vendimi ka të bëjë me faljen e borgjit të tatimit në pronë për vitin 2023, i cili vendim prekë të gjithë tatimpaguesit që kanë detyrime të tatimit mbi pronën e paluajtshme për vitin tatimor 2023 ashtu së dhe është përcaktuar në Nenin 5 Kapitulli II/A, të Ligjit Nr.08/L-224 Për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit NR.06/L005 për Tatimin në Pronën e Paluajtshme.

III.

Për zbatimin e këtij vendimi kujdesen: Kryetari i Komunës, Drejtoria për Buxhet dhe Financa - Zyra e Tatimit në Pronë në bashkpunim me Ministrinë e Financave, Punës dhe Trasnfereve - Departamentin e Tatimit në Pronë.

IV.

Pjesë përbërëse e këtij vendimi është: Ligji Nr.08/L-224 Për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit NR.06/L005 për Tatimin në Pronën e Paluajtshme.

V.

Me këtë Vendim do të njoftohen organët kompetente të Komunës së Drenasit, Ministria e Financave, Punës dhe Trasnfereve – Departamenti i Tatimit në Pronë.

VI.

Ky Vendim hynë në fuqi pas miratimit në Kuvendin e Komunës së Drenasit, dhe pas marrjes së ligjslunërisë nga MAPL.



KRYETARI I KOMUNËS

Ramiz Lladrovci

A r s y e t i m

Në bazë të Neni 11/B paragrafi 2 i Ligjit Nr.08/L-224 Për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit NR.06/L005 për Tatimin në Pronën e Paluajtshme, i cili thotë: Vendimi për faljen e tatimit në prone merret nga kuvendi komunal I çdo komune më së largu 30 ditë nga hyrja në fuqi e këtij ligji, sipas kufizimit të përcaktuar në paragrafin 1 të këtij neni I cili thotë: shuma e faljes së tatimit në prone për të gjithë tatimpaguesit lejohet deri në lartësinë e faturës së tatimit në prone për vitin 2023, por jo më shumë se njëqind (100) euro në pajtim me dispozitat e këtij kapitulli.

Për më shumë detaje bashkangjitur me këtë propozim vendim është edhe Ligjit Nr.08/L-224 Për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit NR.06/L005 për Tatimin në Pronën e Paluajtshme.

LIGJI NR. 08/L-224**PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT NR. 06/L-005 PËR TATIMIN NË PRONËN E PALUAJTSHME**

Kuvendi i Republikës së Kosovës,

Në mbështetje të nenit 65 (1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës,

Miraton:

LIGJ PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT NR. 06/L-005 PËR TATIMIN NË PRONËN E PALUAJTSHME**Neni 1
Qëllimi**

Qëllimi i këtij ligji është të sigurojë progresivitet të shkallës tatimore, lirim tatimor për vendbanimin parësor dhe tokat bujqësore, faljen tatimore për vitin tatimor 2023 dhe rregullat kufizuese për aplikimin e detyrimit tatimor, dhe interesit, përmes ndryshimit dhe plotësimit të Ligjit Nr. 06/L-005 për Tatimin në Pronën e Paluajtshme (në tekstin e mëtejshëm: Ligji Bazik).

Neni 2

Riformulohet neni 9 i Ligjit Bazik dhe zëvendësohet me tekstin si në vijim:

**Neni 9
Shkalla tatimore progresive**

1. Tatimi në pronën e paluajtshme bazohet në vlerën e vlerësuar të paluajtshmërisë së tatimpaguesit si bazë tatimore në komunën përkatëse.

2. Baza tatimore për tatimpaguesin me prona të paluajtshme brenda një komune përcaktohet si bazë e vetme tatimore sipas vlerës së kombinuar të të gjitha pronave të paluajtshme të tatimpaguesit.

3. Vlera e detyrimit tatimor llogaritet sipas kufijve në vijim:

3.1. Për vlerën e pronave deri në njëqindmijë (100,000.00) euro aplikohet shkalla tatimore që mund të variojë prej 0.10% deri 1%;

3.2. Për vlerën e pronave mbi njëqind mijë (100,000.00) euro aplikohet shkalla tatimore që mund të variojë prej 0.20% deri 1%, plus tatimi nga nën-paragrafi 3.1 të këtij neni;

3.3. Për vlerën e pronave mbi pesë qind mijë (500,000.00) euro aplikohet shkalla tatimore që mund të variojë prej 0.30% deri 1%, plus tatimi nga nën-paragrafët 3.1 dhe 3.2 të këtij neni;

3.4. Për vlerën e pronave mbi një milion (1,000,000.00) euro aplikohet shkalla tatimore që mund të variojë prej 0.40% deri 1%, plus tatimi nga nën paragrafët 3.1, 3.2 dhe 3.3 të këtij neni; dhe

3.5. Për vlerën e pronave mbi pesë milionë (5,000,000.00) euro aplikohet shkalla tatimore që mund të variojë prej 0.50% deri 1%, plus tatimi nga nën-paragrafët 3.1, 3.2, 3.3 dhe

3.4 të këtij neni.

4. Kuvendi i Komunës cakton shkallën e aplikueshme tatimore për çdo kufi tatimor sipas paragrafit 3 të këtij neni, deri me 30 nëntor të vitit para vitit të vendosjes së tatimit. Shkallët tatimore të përcaktuara nga komuna duhet të kenë trend progresiv.

5. Nëse Kuvendi i Komunës nuk e përcakton me kohë shkallën e tatimit sipas paragrafit 4 të këtij neni, ministria përgjegjëse për financa do të zbatojë shkallën e fundit tatimore të përcaktuar nga Kuvendi i Komunës.

6. Në rast se shkalla tatimore nuk është vendosur më parë, ministria përgjegjëse për financa do të zbatojë shkallën më të ulët tatimore të aplikueshme në përputhje me kufijtë e tatimit progresiv të pronës së paluajtshme përcaktuara në këtë nen."

Neni 3

1. Pas paragrafit 1, nën-paragrafit 1.7 të nenit 10 të Ligjit Bazik, shtohen dy nën-paragrafë me tekstin si në vijim:

1.8. Për vendbanimin parësor, deri në tridhjetë mijë (30,000) euro e para të pronës së vlerësuar të personit fizik i cili vendos deri më 30 nëntor të vitit para vitit tatimor se njësia e objektit shërben si vendbanim parësor dhe e deklaron këtë në komunë apo gjatë fazës së inspektimit; dhe

1.9. Për tokën bujqësore, deri në pesëdhjetë mijë (50,000) euro e para të pronës së vlerësuar si njësi bujqësore të personit fizik i cili vendos deri më 30 nëntor të vitit para vitit tatimor për cilën njësi bujqësore e kërkon lirimin dhe e deklaron këtë në komunë apo gjatë fazës së inspektimit.

2. Fshihen paragrafët 4 dhe 5 të nenit 10 të Ligjit Bazik, dhe vendoset një paragraf i ri me tekstin si në vijim:

4. Lirimet tatimore të përcaktuara me nën-paragrafët 1.8 dhe 1.9, të paragrafit 1 të nenit 10 zbatohen vetëm një herë brenda vitit tatimor për çdo tatimpagues, pavarësisht nga numri i pronësive dhe/ose posedimeve të tatimpaguesit dhe pavarësisht faktit që njësitë mund të ndodhen në komuna të ndryshme.

Neni 4

Fshihet neni 11 i Ligjit Bazik.

Neni 5

Pas Kapitulli II të Ligjit bazik, shtohet Kapitulli II/A me tekstin si në vijim:

KAPITULLI II/A

FALJA E TATIMIT NË PRONË PËR VITIN TATIMOR 2023

Neni 11/A Pranueshmëria

Çdo tatimpagues që është i detyruar të paguajë tatimin mbi pronën e paluajtshme për vitin tatimor 2023 kualifikohet për faljen e tatimit të parashikuar me dispozitat e këtij kapitulli.

Neni 11/B**Shuma e faljes së tatimit në pronë për pronën e paluajtshme**

1. Shuma e faljes së tatimit në pronë për të gjithë tatimpaguesit lejohet deri në lartësinë e faturës së tatimit në pronë për vitin 2023, por jo më shumë se njëqind (100) euro në pajtim me dispozitat e këtij kapitulli.
2. Vendimi për faljen e tatimit në pronë merret nga kuvendi komunal i çdo komune më së largu 30 ditë nga hyrja në fuqi e këtij ligji, sipas kufizimit të përcaktuar në paragrafin 1 të këtij neni.
3. Në rast se tatimpaguesi ka paguar faturën e tatimit në pronë për vitin 2023, shuma e falur i llogaritet si paradhënie për vitet pasuese.

Neni 11/C**Kufizimi**

Falja tatimore e parashikuar me këtë kapitull zbatohet vetëm për vitin tatimor 2023 dhe nuk do të zbatohet për asnjë vit tjetër tatimor.

Neni 11/Ç**Administrimi**

1. Zbatimi i këtij kapitulli mbetet përgjegjësi e çdo komune përgjegjëse për administrimin e procesit të tatimit në pronë për pronat e paluajtshme që ndodhen brenda territorit të komunës.
2. Ministria përgjegjëse për financa nxjerr vendime që mund të jenë të nevojshme për zbatimin e këtij kapitulli.

Neni 6

Pas paragrafi 1 të nenit 23 të Ligjit Bazik, shtohet paragrafi 1.a. me tekstin si në vijim:

- 1.a. Për vitin tatimor 2024 dhe vitet tatimore pasuese, detyrimi tatimor për personat jo-rezidentë mund të paguhet në një kësht të vetëm, më së largu në datën 30 shtator të vitit tatimor përkatës.

Neni 7

Pas paragrafit 2 të nenit 25 të Ligjit Bazik, shtohet paragrafi 3 me tekstin si në vijim:

3. Në asnjë rrethanë llogaritja e interesit në tatimin e papaguar nuk do të vazhdojë të llogaritet pasi interes i akumuluar të ketë arritur shumën e vetë tatimit të papaguar.

Neni 8

Pas nenit 30 të Ligjit bazik, shtohet neni 30/A me tekstin si në vijim:

Neni 30/A**Afati i parashkrimit të detyrimit tatimor**

1. Afati i parashkrimit të përmbartimit të detyrimit tatimor është dhjetë (10) vjeçar, duke filluar nga data e marrjes së vendimit mbi ekzekutimin e detyrimeve tatimore të papaguara sipas nenit 30 të Ligjit Bazik.
2. Pas skadimit të periudhës dhjetë (10) vjeçare, detyrimi tatimor konsiderohet i parashkruar dhe komuna nuk ka të drejtë të marrë asnjë masë përmbartimore ndaj tatimpaguesit.

3. Parashkrimi nuk zbatohet në rastet kur:

3.1. Tatimpaguesi ka paguar vullnetarisht një pjesë të detyrimit tatimor pas skadimit të periudhës dhjetëvjeçare;

3.2. Tatimpaguesi ka rënë dakord me komunën për një plan pagese ose shlyerje të detyrimit tatimor; dhe

3.3. Për detyrimin tatimor është marrë një vendim gjyqësor.

4. Afati i parashkrimit pezullohet gjatë procedurës ankimore ose gjatë një procesi gjyqësor në lidhje me detyrimin tatimor.

5. Afati i parashkrimit rifillon nga data e vendimit përfundimtar të marrë në ankim ose procedurë gjyqësore.

Neni 9

Në kapitullin X të Ligjit Bazik, Dispozita kalimtare dhe përfundimtare, pas nenit 39, shtohet një nen i ri, 39 /A, me tekstin si vijon:

Neni 39 /A

Shkalla tatimore tranzitore

Për vitin tatimor 2024 për të gjitha kategoritë e pronave të përcaktuara në nenin 9, paragrafin 1 të Ligjit Bazik, Kuvendet Komunale deri më 30 nëntor 2023 mund të përcaktojnë shkallën tatimore të aplikueshme e cila mund të variojë prej 0.1% deri 1%. Në rast se Kuvendet Komunale nuk marrin vendim për përcaktimin e normave tatimore, vlejnë dispozitat e ligjit bazik.

Neni 10

Hyrja në fuqi

1. Ky ligj hyn në fuqi në ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

2. Neni 2 i këtij ligji fillon të zbatohet për vitin tatimor 2025, dhe obligohet Kuvendi i Komunës që deri më 30 nëntor të vitit 2024 t'i caktojë shkallët tatimore konform nenit 2 të këtij ligji.

Ligji Nr. 08/L-224
27 korrik 2023

Shpallur me dekretin Nr. DL-148/2023, datë 14.08.2023 nga Presidentja e Republikës së Kosovës Vjosa Osmani-Sadriu

Nr. 1240

REPUBLIKA E KOSOVËS KOMUNA GLLOGOC GLLOGOC MUNICIPALITY			
PRANUAR		21.08	2023
Nj. Org.	Numër	Shtojca	Vlera
01	432/02	41248	



**Republike e Kosovës
Komuna e Gllogocit
Zyra e Kryetarit**

Në mbështetje të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, Neni 9 i Ligjit Nr.08/L-224 Për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr.06/L005 për Tatimin në Pronën e Paluajtshme, si dhe në bazë të Statutit të Komunës së Drenasit, Kryetari i Komunës së Drenasit, propozon këtë:

PROPOZIMVENDIM

- **Për caktimin e normave tatimore për Tatimin në Pronën e Paluajtshme për vitin 2024**

Neni 1

Normat Tatimore

Në zbatim të Ligjit Nr.08/L-224 Për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr.06/L005 për Tatimin në Pronën e Paluajtshme, neni 9, paragrafi 4, Kuvendi Komunal i Komunës së Gllogocit cakton normat tatimore për vitin 2024 për të gjitha kategoritë e pronave, me përjashtim të kategorisë pronë publike, si vijon:

- Për vlerën e pronave deri në njëqindmijë (100.000) euro aplikohet shkalla tatimore -0.10%
- Për vlerën e pronave mbi njëqindmijë (100.000) euro aplikohet shkalla tatimore - 0.20%, plus tatimi nga nën-paragrafi 3.1 i këtij neni;
- Për vlerën e pronave mbi pesëqindmijë (500.000) euro aplikohet shkalla tatimore - 0.30% plus tatimi nga nën-paragrafët 3.1 dhe 3.2 të këtij neni;
- Për vlerën e pronave mbi një milion (1.000.000) euro aplikohet shkalla tatimore - 0.40% plus tatimi nga nën-paragrafët 3.1, 3.2 dhe 3.3 të këtij neni;
- Për vlerën e pronave mbi pesë milion (5.000.000) euro aplikohet shkalla tatimore - 0.50% plus tatimi nga nën-paragrafët 3.1, 3.2, 3.3 dhe 3.4 të këtij neni;

Neni 2

Zbatimi

Për zbatimin e këtij vendimi obligohet Drejtoria për Buxhet dhe Financa - Zyra e Tatimit në Pronë.

Neni 3

Me këtë Vendim do të njoftohen organët kompetente të Komunës së Drenasit

Neni 4

Hyrja në fuqi

Vendimi hyn në fuqi 8 ditë pas miratimit nga ana e Kuvendit Komunal dhe do të filloj së zbatuari nga 1 janari 2024.



Kryetari i Komunës

Ramiz Lladrovci

Arsyetim

Në zbatim të Ligjit Nr.08/L-224 Për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr.06/L005 për Tatimin në Pronën e Paluajtshme, neni 9, paragrafi 4, Kuvendi Komunal i Komunës së Gllogocit cakton normat tatimore për vitin 2024 për të gjitha kategoritë e pronave.

Për sqarime të më tutjeshme e gjeni të bashkangjitur Ligjin Nr.08/L-224 Për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr.06/L005 për Tatimin në Pronën e Paluajtshme.

LIGJI NR. 08/L-224

**PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT NR. 06/L-005 PËR TATIMIN NË PRONËN
E PALUAJTSHME**

Kuvendi i Republikës së Kosovës,

Në mbështetje të nenit 65 (1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës,

Miraton:

**LIGJ PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT NR. 06/L-005 PËR TATIMIN NË
PRONËN E PALUAJTSHME**

**Neni 1
Qëllimi**

Qëllimi i këtij ligji është të sigurojë progresivitet të shkallës tatimore, lirim tatimor për vendbanimin parësor dhe tokat bujqësore, faljen tatimore për vitin tatimor 2023 dhe rregullat kufizuese për aplikimin e detyrimit tatimor, dhe interesit, përmes ndryshimit dhe plotësimit të Ligjit Nr. 06/L-005 për Tatimin në Pronën e Paluajtshme (në tekstin e mëtejshëm: Ligji Bazik).

Neni 2

Riformulohet neni 9 i Ligjit Bazik dhe zëvendësohet me tekstin si në vijim:

**Neni 9
Shkalla tatimore progresive**

1. Tatimi në pronën e paluajtshme bazohet në vlerën e vlerësuar të paluajtshmërisë së tatimpaguesit si bazë tatimore në komunën përkatëse.
2. Baza tatimore për tatimpaguesin me prona të paluajtshme brenda një komune përcaktohet si bazë e vetme tatimore sipas vlerës së kombinuar të të gjitha pronave të paluajtshme të tatimpaguesit.
3. Vlera e detyrimit tatimor llogaritet sipas kufijve në vijim:
 - 3.1. Për vlerën e pronave deri në njëqindmijë (100,000.00) euro aplikohet shkalla tatimore që mund të variojë prej 0.10% deri 1%;
 - 3.2. Për vlerën e pronave mbi njëqind mijë (100,000.00) euro aplikohet shkalla tatimore që mund të variojë prej 0.20% deri 1%, plus tatimi nga nën-paragrafi 3.1 të këtij neni;
 - 3.3. Për vlerën e pronave mbi pesë qind mijë (500,000.00) euro aplikohet shkalla tatimore që mund të variojë prej 0.30% deri 1%, plus tatimi nga nën-paragrafët 3.1 dhe 3.2 të këtij neni;
 - 3.4. Për vlerën e pronave mbi një milion (1,000,000.00) euro aplikohet shkalla tatimore që mund të variojë prej 0.40% deri 1%, plus tatimi nga nën paragrafët 3.1, 3.2 dhe 3.3 të këtij neni; dhe
 - 3.5. Për vlerën e pronave mbi pesë milionë (5,000,000.00) euro aplikohet shkalla tatimore që mund të variojë prej 0.50% deri 1%, plus tatimi nga nën-paragrafët 3.1, 3.2, 3.3 dhe

3.4 të këtij neni.

4. Kuvendi i Komunës cakton shkallën e aplikueshme tatimore për çdo kufi tatimor sipas paragrafit 3 të këtij neni, deri me 30 nëntor të vitit para vitit të vendosjes së tatimit. Shkallët tatimore të përcaktuara nga komuna duhet të kenë trend progresiv.

5. Nëse Kuvendi i Komunës nuk e përcakton me kohë shkallën e tatimit sipas paragrafit 4 të këtij neni, ministria përgjegjëse për financa do të zbatojë shkallën e fundit tatimore të përcaktuar nga Kuvendi i Komunës.

6. Në rast se shkalla tatimore nuk është vendosur më parë, ministria përgjegjëse për financa do të zbatojë shkallën më të ulët tatimore të aplikueshme në përputhje me kufijtë e tatimit progresiv të pronës së paluajtshme përcaktuara në këtë nen."

Neni 3

1. Pas paragrafit 1, nën-paragrafit 1.7 të nenit 10 të Ligjit Bazik, shtohen dy nën-paragrafë me tekstin si në vijim:

1.8. Për vendbanimin parësor, deri në tridhjetë mijë (30,000) euro e para të pronës së vlerësuar të personit fizik i cili vendos deri më 30 nëntor të vitit para vitit tatimor se njësia e objektit shërben si vendbanim parësor dhe e deklaron këtë në komunë apo gjatë fazës së inspektimit; dhe

1.9. Për tokën bujqësore, deri në pesëdhjetë mijë (50,000) euro e para të pronës së vlerësuar si njësi bujqësore të personit fizik i cili vendos deri më 30 nëntor të vitit para vitit tatimor për cilën njësi bujqësore e kërkon lirimin dhe e deklaron këtë në komunë apo gjatë fazës së inspektimit.

2. Fshihen paragrafët 4 dhe 5 të nenit 10 të Ligjit Bazik, dhe vendoset një paragraf i ri me tekstin si në vijim:

4. Lirimet tatimore të përcaktuara me nën-paragrafët 1.8 dhe 1.9, të paragrafit 1 të nenit 10 zbatohen vetëm një herë brenda vitit tatimor për çdo tatimpagues, pavarësisht nga numri i pronësive dhe/ose posedimeve të tatimpaguesit dhe pavarësisht faktit që njësitë mund të ndodhen në komuna të ndryshme.

Neni 4

Fshihet neni 11 i Ligjit Bazik.

Neni 5

Pas Kapitulli II të Ligjit bazik, shtohet Kapitulli II/A me tekstin si në vijim:

KAPITULLI II/A

FALJA E TATIMIT NË PRONË PËR VITIN TATIMOR 2023

Neni 11/A Pranueshmëria

Çdo tatimpagues që është i detyruar të paguajë tatimin mbi pronën e paluajtshme për vitin tatimor 2023 kualifikohet për faljen e tatimit të parashikuar me dispozitat e këtij kapitulli.

Neni 11/B**Shuma e faljes së tatimit në pronë për pronën e paluajtshme**

1. Shuma e faljes së tatimit në pronë për të gjithë tatimpaguesit lejohet deri në lartësinë e faturës së tatimit në pronë për vitin 2023, por jo më shumë se njëqind (100) euro në pajtim me dispozitat e këtij kapitulli.
2. Vendimi për faljen e tatimit në pronë merret nga kuvendi komunal i çdo komune më së largu 30 ditë nga hyrja në fuqi e këtij ligji, sipas kufizimit të përcaktuar në paragrafin 1 të këtij neni.
3. Në rast se tatimpaguesi ka paguar faturën e tatimit në pronë për vitin 2023, shuma e falur i llogaritet si paradhënie për vitet pasuese.

Neni 11/C**Kufizimi**

Falja tatimore e parashikuar me këtë kapitull zbatohet vetëm për vitin tatimor 2023 dhe nuk do të zbatohet për asnjë vit tjetër tatimor.

Neni 11/Ç**Administrimi**

1. Zbatimi i këtij kapitulli mbetet përgjegjësi e çdo komune përgjegjëse për administrimin e procesit të tatimit në pronë për pronat e paluajtshme që ndodhen brenda territorit të komunës.
2. Ministria përgjegjëse për financa nxjerr vendime që mund të jenë të nevojshme për zbatimin e këtij kapitulli.

Neni 6

Pas paragrafi 1 të nenit 23 të Ligjit Bazik, shtohet paragrafi 1.a. me tekstin si në vijim:

- 1.a. Për vitin tatimor 2024 dhe vitet tatimore pasuese, detyrimi tatimor për personat jo-rezidentë mund të paguhet në një kësht të vetëm, më së largu në datën 30 shtator të vitit tatimor përkatës.

Neni 7

Pas paragrafit 2 të nenit 25 të Ligjit Bazik, shtohet paragrafi 3 me tekstin si në vijim:

3. Në asnjë rrethanë llogaritja e interesit në tatimin e papaguar nuk do të vazhdojë të llogaritet pasi interesi i akumuluar të ketë arritur shumën e vetë tatimit të papaguar.

Neni 8

Pas nenit 30 të Ligjit bazik, shtohet neni 30/A me tekstin si në vijim:

Neni 30/A**Afati i parashkrimit të detyrimit tatimor**

1. Afati i parashkrimit të përmbartimit të detyrimit tatimor është dhjetë (10) vjeçar, duke filluar nga data e marrjes së vendimit mbi ekzekutimin e detyrimeve tatimore të papaguara sipas nenit 30 të Ligjit Bazik.
2. Pas skadimit të periudhës dhjetë (10) vjeçare, detyrimi tatimor konsiderohet i parashkruar dhe komuna nuk ka të drejtë të marrë asnjë masë përmbartimore ndaj tatimpaguesit.

3. Parashkrimi nuk zbatohet në rastet kur:

3.1. Tatimpaguesi ka paguar vullnetarisht një pjesë të detyrimit tatimor pas skadimit të periudhës dhjetëvjeçare;

3.2. Tatimpaguesi ka rënë dakord me komunën për një plan pagese ose shlyerje të detyrimit tatimor; dhe

3.3. Për detyrimin tatimor është marrë një vendim gjyqësor.

4. Afati i parashkrimit pezullohet gjatë procedurës ankimore ose gjatë një procesi gjyqësor në lidhje me detyrimin tatimor.

5. Afati i parashkrimit rifillon nga data e vendimit përfundimtar të marrë në ankim ose procedurë gjyqësore.

Neni 9

Në kapitullin X të Ligjit Bazik, Dispozita kalimtare dhe përfundimtare, pas nenit 39, shtohet një nen i ri, 39 /A, me tekstin si vijon:

Neni 39 /A

Shkalla tatimore tranzitore

Për vitin tatimor 2024 për të gjitha kategoritë e pronave të përcaktuara në nenin 9, paragrafin 1 të Ligjit Bazik, Kuvendet Komunale deri më 30 nëntor 2023 mund të përcaktojnë shkallën tatimore të aplikueshme e cila mund të variojë prej 0.1% deri 1%. Në rast se Kuvendet Komunale nuk marrin vendim për përcaktimin e normave tatimore, vlejnë dispozitat e ligjit bazik.

Neni 10

Hyrja në fuqi

1. Ky ligj hyn në fuqi në ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

2. Neni 2 i këtij ligji fillon të zbatohet për vitin tatimor 2025, dhe obligohet Kuvendi i Komunës që deri më 30 nëntor të vitit 2024 t'i caktojë shkallët tatimore konform nenit 2 të këtij ligji.

Ligji Nr. 08/L-224
27 korrik 2023

Shpallur me dekretin Nr. DL-148/2023, datë 14.08.2023 nga Presidentja e Republikës së Kosovës Vjosa Osmani-Sadriu

REPUBLIKA E KOSOVËS KOMUNA GLLOGOC GLLOGOC MUNICIPALITY			
PRANUAR		21. 08 2023	
Nj. Org.	Numër	Shtojca	Vlera
01	400/01	41375	



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Komuna e Drenasit
Zyra e Kryetarit



Në vështrim të nenit 58, paragrafi 1, nënparagrafi h të Ligjit për Vetëqeverisjes Lokale nr.03/L-40, nenit 34.6 të Statutit të Komunës së Drenasit, Rregullores 12 nr.320-10338 dhe plotsim ndryshimit të rregullorës: Nr.02-400/01-18380 të dt. 27.04.2022 për kushtet, kriteret dhe procedurat e ndarjes së subvencioneve, rregullores MF-NR 04/2017 Mbi kriteret, Standardet dhe Procedurat e Financimit Publik të OJQ-ve, vendimit me nr.12-400-37743 të datës 03.07.2018 për plotësim ndryshimin e Rregullores nr 12-320-19338 për kushtet, kriteret dhe procedurat e ndarjes së subvencioneve, pastaj Buxheti i miratuar nga Kuvendi i Komunës së Drenasit për vitin 2023. Me propozim të Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport, Kryetari i Komunës para Kuvendit paraqet këtë:

P R O P O Z I M V E N D I M P Ë R F I N A N C I M I N E P R O J E K T I T

Neni 1.

Me këtë propozim vendim, kërkohet mbështetja financiare për projektin e OJQ “Klubi i Hendbollit Drenica” Lidhur me mbulimin e shpenzimeve për mbulimin e shpenzimeve për Projektin “Aktivitete Sportive” gjatë vitit 2023.

Neni 2.

Projekti i OJQ “Klubi i Hendbollit Drenica” përkrahet me shumën prej **8,000.00 €** (tetë mijë euro) mjetet të cilat do të shfrytëzohen për mbulimin e shpenzimeve për vitin 2023 .

Neni 3.

Financimi-Subvencionimi i projektit do të bëhet nga Buxheti i DKRS nga kategoria ekonomike e shpenzimeve, subvencione dhe transfereve , kodi ekonomik 21/611/850001/21200/0000/0820.

Neni 4.

Mjetet financiare barten në Konton e OJQ “Klubi i Hendbollit Drenica” Drejtorati i Kulturës, Rinisë dhe Sportit është obliguar që për shumën e mjeteve për financimin e përmendur në nenin 2. Të këtij propozim vendimi të përcjellë implementimin e projektit, duke kërkuar nga OJQ “Klubi i Hendbollit Drenica” që të bëjë raport tekstual dhe financiar në mënyrë që të njoftoj DKRS për mënyrën e shpenzimeve të mjeteve financiare.

Neni 5.

Ky vendim hynë në fuqi ditën e aprovimit nga ana e Kuvendit të Komunës së Drenasit, për zbatimin e tij do të kujdeset: Kryetari i Komunës, Drejtorati për Buxhet dhe Financa Dhe Drejtorati për Kulturë, Rini dhe Sport.



KRYETARI I KOMUNËS

Ramiz Lladrovci

A r s y e t i m

Bazuar në thirrjen publike nr. 01-400/01-25649 të dt.31.05.2023 nga Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport për ndarjen e subvencioneve për Klubet Sportive, Sportistët, Garat Sportive, Shoqëritë Amatore, Teatrot Amatore , Festivalet, Botimi i librave/ Shkrimeve letrare, Ekspozitat me fotografi/ picture, Aktivitetet me karakter garues, Pjesëmarrje në festival jashtë komune, Promovimi i talentave të rinjë për vitin 2023, OJQ "KH DRENICA" Klub i Hendbollit, ka aplikuar më dt. 29/06/2023 me projektin "Aktivitete Sportive".

Me propozim të Komisionit për Shqyrtimin dhe Vlerësimin e kërkesave për ndarje të subvencioneve të OJQ-ve, Kryetari I Komunës propozon Kuvendit përkrahjen me mjete financiare për OJQ-në ose personin fizik në realizimin e projektit KH Drenica "Aktivitete Sportive", në shumën prej 8,000 €.

REPUBLIKA E KOSOVËS KOMUNA GLLOGOC GLLOGOC MUNICIPALITY			
NJAR		21.08 2023	
Org.	Numër	Shtojca	Vlera
01	400/01-61381		



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Komuna e Drenasit
Zyra e Kryetarit



Në vështrim të nenit 58, paragrafi 1, nënparagrafi h të Ligjit për Vetëqeverisjes Lokale nr.03/L-40, nenit 34.6 të Statutit të Komunës së Drenasit, Rregullores 12 nr.320-10338 dhe plotsim ndryshimit të rregullorës: Nr.02-400/01-18380 të dt. 27.04.2022 për kushtet, kriteret dhe procedurat e ndarjes së subvencioneve, rregullores MF-NR 04/2017 Mbi kriteret, Standardet dhe Procedurat e Financimit Publik të OJQ-ve, vendimit me nr.12-400-37743 të datës 03.07.2018 për plotësim ndryshimin e Rregullores nr 12-320-19338 për kushtet, kriteret dhe procedurat e ndarjes së subvencioneve, pastaj Buxheti i miratuar nga Kuvendi i Komunës së Drenasit për vitin 2023. Me propozim të Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport, Kryetari i Komunës para Kuvendit paraqet këtë:

PROPOZIM VENDIM PËR FINANCIMIN E PROJEKTIT

Neni 1.

Me këtë propozim vendim, kërkohet mbështetja financiare për projektin e OJQ "FC Liqeni" Lidhur me mbulimin e shpenzimeve për mbulimin e shpenzimeve për Projektin "Aktivitete Sportive" gjatë vitit 2023.

Neni 2.

Projekti i OJQ "FC Liqeni" përkrahët me shumën prej **15,000.00 €** (pesëdhjetë mijë euro) mjetet të cilat do të shfrytëzohen për mbulimin e shpenzimeve për vitin 2023.

Neni 3.

Financimi-Subvencionimi i projektit do të bëhet nga Buxheti i DKRS nga kategoria ekonomike e shpenzimeve, subvencione dhe transfereve, kodi ekonomik 22/611/850001/21200/0000/0820.

Neni 4.

Mjetet financiare barten në Konton e **OJQ "FC Liqeni"**. Drejtorati i Kulturës, Rinisë dhe Sportit është obliguar që për shumën e mjeteve për financimin e përmendur në nenin 2. Të këtij propozim vendimi të përcjellë implementimin e projektit, duke kërkuar nga OJQ "FC Liqeni" që të bëjë raport tekstual dhe financiar në mënyrë që të njoftoj DKRS për mënyrën e shpenzimeve të mjeteve financiare.

Neni 5.

Ky vendim hynë në fuqi ditën e aprovimit nga ana e Kuvendit të Komunës së Drenasit, për zbatimin e tij do të kujdeset: Kryetari i Komunës, Drejtorati për Buxhet dhe Financa Dhe Drejtorati për Kulturë, Rini dhe Sport.



KRYETARI I KOMUNËS

Ramiz Lladrovci

Arsyetim

Bazuar në thirrjen publike nr. 01-400/01-25649 të dt.31.05.2023 nga Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport për ndarjen e subvencioneve për Klubet Sportive, Sportistët, Garat Sportive, Shoqëritë Amatore, Teatrot Amatore , Festivalet, Botimi i librave/ Shkrimeve letrare, Ekspozitat me fotografi/ picture, Aktivitetet me karakter garues, Pjesëmarrje në festival jashtë komune, Promovimi i talentave të rinjë për vitin 2023, OJQ "FC LIQENI" Klub i Futsallit, ka aplikuar më dt. 30/06/2023 me projektin "Aktivitete Sportive".

Me propozim të Komisionit për Shqyrtimin dhe Vlerësimin e kërkesave për ndarje të subvencioneve të OJQ-ve, Kryetari I Komunës propozon Kuvendit përkrahjen me mjete financiare për OJQ-në ose personin fizik në realizimin e projektit "FC LIQENI "Aktivitete Sportive", në shumën prej 15,000 €.

REPUBLIKA E KOSOVES KOMUNA GLLOGOC GLLOGOC MUNICIPALITY			
PRANUAR		21/08/	2023
Nj. Org.	Numër	Shtojca	Vlera
01-	400/01-	41364	



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Komuna e Drenasit
Zyra e Kryetarit



Në vështrim të nenit 58, paragrafi 1, nënparagrafi h të Ligjit për Vetëqeverisjes Lokale nr.03/L-40, nenit 34.6 të Statutit të Komunës së Drenasit, Rregullores 12 nr.320-10338 dhe plotsim ndryshimit të rregullorës: Nr.02-400/01-18380 të dt. 27.04.2022 për kushtet, kriteret dhe procedurat e ndarjes së subvencioneve, rregullores MF-NR 04/2017 Mbi kriteret, Standardet dhe Procedurat e Financimit Publik të OJQ-ve, vendimit me nr.12-400-37743 të datës 03.07.2018 për plotësim ndryshimin e Rregullores nr 12-320-19338 për kushtet, kriteret dhe procedurat e ndarjes së subvencioneve, pastaj Buxheti i miratuar nga Kuvendi i Komunës së Drenasit për vitin 2023. Me propozim të Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport, Kryetari i Komunës para Kuvendit paraqet këtë:

PROPOZIM VENDIM PËR FINANCIMIN E PROJEKTIT

Neni 1.

Me këtë propozim vendim, kërkohet mbështetja financiare për projektin e OJQ “Klubi i Boksit Drenasi” Lidhur me mbulimin e shpenzimeve për mbulimin e shpenzimeve për Projektin “Masivizimi I sportit të boksit” gjatë vitit 2023.

Neni 2.

Projekti i OJQ “Klubi i Boksit Drenasi” përkrahet me shumën prej **3,000.00 €** (tre mijë euro) mjetet të cilat do të shfrytëzohen për mbulimin e shpenzimeve për vitin 2023 .

Neni 3.

Financimi-Subvencionimi i projektit do të bëhet nga Buxheti i DKRS nga kategoria ekonomike e shpenzimeve, subvencione dhe transfereve , kodi ekonomik 21/611/850001/21200/0000/0820.

Neni 4.

Mjetet financiare barten në Konton e OJQ “Klubi i Boksit Drenasi” Drejtorati i Kulturës, Rinisë dhe Sportit është obliguar që për shumën e mjeteve për financimin e përmendur në nenin 2. Të këtij propozim vendimi të përcjellë implementimin e projektit, duke kërkuar nga OJQ “Klubi i Boksit Drenasi” që të bëjë raport tekstual dhe financiar në mënyrë që të njoftoj DKRS për mënyrën e shpenzimeve të mjeteve financiare.

Neni 5.

Ky vendim hynë në fuqi ditën e aprovimit nga ana e Kuvendit të Komunës së Drenasit, për zbatimin e tij do të kujdeset: Kryetari i Komunës, Drejtorati për Buxhet dhe Financa Dhe Drejtorati për Kulturë, Rini dhe Sport.



KRYETARI I KOMUNËS

Ramiz Lladrovci

Arsyetim

Bazuar në thirrjen publike nr. 01-400/01-25649 të dt.31.05.2023 nga Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport për ndarjen e subvencioneve për Klubet Sportive, Sportistët, Garat Sportive, Shoqëritë Amatore, Teatrot Amatore , Festivalet, Botimi i librave/ Shkrimeve letrare, Ekspozitat me fotografi/ picture, Aktivitetet me karakter garues, Pjesëmarrje në festival jashtë komune, Promovimi i talentave të rinjë për vitin 2023, OJQ "Klubi I Boksit Drenasi" Klub i boksit ka aplikuar më dt. 21/06/2023 me projektin "Masovizimi I Sportit të Boksit".

Me propozim të Komisionit për Shqyrtimin dhe Vlerësimin e kërkesave për ndarje të subvencioneve të OJQ-ve, Kryetari I Komunës propozon Kuvendit përkrahjen me mjete financiare për OJQ ose personin fizik në realizimin e projektit Klubi I Boksit Drenasi "Masovizimi I Sportit të Boksit", në shumën prej 3,000 €.

REPUBLIKA E KOSOVËS			
KOMUNA E GLOGOC			
MUNICIPALITY			
PRANUA		21/08 2023	
Nj. Org.	Natë	Shifra	Vlera
01-400/01-41370			



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Komuna e Drenasit
Zyra e Kryetarit



